



UDHËZIME PËR TË NDIHMUAR PJESËMARRJEN E PAKICAVE KOMBËTARE NË PROCESIN E ZGJEDHJEVE

OSCE

UDHËZIME PËR TË NDIHMUAR PJESËMARRJEN E PAKICAVE KOMBËTARE NË PROCESIN E ZGJEDHJEVE

osce

UDHËZIME PËR TË NDIHMUAR
PJESËMARRJEN E PAKICAVE
KOMBËTARE NË PROCESIN E
ZGJEDHJEVE

Të drejtat e autorit janë të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund lirisht të kopjohet për qëllime edukuese dhe qëllime tjera jokomerciale, me kusht që riprodhimet e tilla të shoqërohen me një mirënjohje të OSBE/ODIHR si burimi i tyre.

Ky publikim është një përkthim i titullit të ODIHR-it “Udhëzime për të Ndhimuar Pjesëmarrjen e Pakicave Kombëtare në Procesin e Zgjedhjeve”, OSCE/ODIHR 2004 përpunuar nga Misioni Vëzhgues i OSBE-së në Shkup.

Fotografitë u mundësuan nga Misioni Vëzhgues i OSBE-së në Shkup.

Misioni Vëzhgues i OSBE-së në Shkup
Ndërtesa QBE, Shkup
11 Oktomvri 25

osce.org/skopje

UDHËZIME PËR TË NDIHMUAR
PJESËMARRJEN E PAKICAVE
KOMBËTARE NË PROCESIN E
ZGJEDHJEVE

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	7
2. SFONDI (HISTORIA) E LUND REKOMANDIMEVE	9
3. RËNDËSIA E PROCESIT	11
4. KORNIZA LIGJORE NDËRKOMBËTARE	13
5. REKOMANDIMET E LUNDIT PËR ZGJEDHJET: NR. 7	17
5.1 Shpjegimi i përmbajtjes	17
5.1.1 Të drejtat individuale për të marrë pjesë në zgjedhje	18
5.1.2 Ndalimi kundër diskriminimit	21
5.2 Korniza ligjore dhe Opsionet	24
6. REKOMANDIMETE LUND-it PËR ZGJEDHJET: Nr. 8	27
6.1 Shpjegimi i përmbajtjes	27
6.2 Korniza legjislativë	29
7. REKOMANDIMET E LUND-it PËR ZGJEDHJET: Nr. 9	31
7.1 Shpjegimi i përmbajtjes	31
7.2 Korniza dhe Opsionet Legjislative	34
7.3 Mekanizmat e tjerë	41
8. REKOMANDIMET E LUND-it PËR ZGJEDHJET: Nr 10	43
8.1 Shpjegimi i përmbajtjes	43
8.1.1 Madhësia e zonës zgjedhore	43
8.1.2 Caktimi i kufijve territorial	44

9. SIGURIMI I RRJEDHJES KORREKTE TË ZGJEDHJEVE: ADMINISTRATA E ZGJEDHJEVE	47
9.1 Opsionet e Organit Zgjedhor.....	48
9.1.1 Qasja e Qeverisë	48
9.1.2 Qasje mbikëqyrëse ose gjyqësore	49
9.1.3 Qasja e Pavarur	49
9.1.4 Qasja e partive politike	49
9.2 Përbërja e Komisionit apo Organit Zgjedhor.....	50
9.2.1 Transparenca	50
9.2.2 Paanshmëria.....	50
9.3 Organet zgjedhore të përhershme/ Ad Hoc	51
 Shtojca I	
Listat kontrolluese	52
 Shtojca II	
Sistemet Zgjedhore: Fjalori i shprehjeve	55
 Shtojca III	
Integrimi i çështjes të pakicave në Vëzhgimin e Zgjedhjeve të ODIHR-it	58
MBIKËQYRJA E ZGJEDHJEVE.....	58
I. Hyrje	58
II. Roli i ODIHR-it në fazën para misionit	59
III. Roli i misionit për vlerësimin e nevojave	60
IV. Roli i ekipit thelbësor i misionit për vëzhgimin e zgjedhjeve	62
V. Roli i vëzhguesve afatgjatë (VAGJ)	65
VI. Roli i vëzhguesve afatshkurtër (VASH).....	66
VII. Raportimi për çështjet e pakicave kombëtare.....	67
VIII. Rekomandime për mvz-të e ardhshme	68
SHTOJCA 1	69
Çështjet e Pakicave Kombëtare dhe teknikat e vëzhgimit	69

1.

HYRJE

Komisionari i Lartë i OSBE-së për Pakicave Kombëtare (KLPK) ka autorizuar një grup ekspertësh të njohur ndërkombëtarisht për të përpiluar rekomandimet për Pjesëmarrje Efektive të Pakicave Kombëtare në Jetën Publike (të quajtur “Rekomandimet e Lundit”).¹ Asistenca për Rekomandimet e Lundit, si një referencë e vlefshme, është shprehur brenda Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE)² dhe shprehimisht e miratuar nga KLPK (HCNM). Me qëllim për tu dhënë efekt më të mirë atyre Rekomandimeve, Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) propozoi të përpilohen udhëzime praktike në lidhje me katër rekomandimet lidhur me zgjedhjet.³

Qëllimet e udhëzimeve janë:

- ▶ Të bëjnë më efektive pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në organet

e vendimmarrjes publike me anë të përfaqësimit të zgjeruar;

- ▶ Të informojnë të gjitha palët e interesuara lidhur me:
 - Opsionet e hapura për një shtet për t’ju dhënë fuqi rekomandimeve;
 - Avantazhet dhe disavantazhet e opsioneve të ndryshme;
 - Të ofrojnë këshilla mbi mjetet kushtetuese, legjislative dhe institucionale për të realizuar ato opsione;
- ▶ Të ndihmojnë shtetet anëtare të OSBE-së dhe ODIHR-it për të siguruar koherencë të aplikimit në praktikën e shteteve standardet mbi të cilat Lund Rekomandimet janë zhvilluar.

Udhëzimet janë përpiluar nga ana e ODIHR-it në bashkëpunim me Institutin

¹ Këto udhëzime janë bazuar në Rekomandimet e Lundit, të qershorit 1999. Për një llogari për shtytjen dhe procesin e përpunimit të tyre, shih John Packer, “origjina dhe natyra e Rekomandimeve të Lundit për Pjesëmarrje Efektive të Pakicave Kombëtare në Jetën Publike”, Helsinki Monitor, Vëllimi 11, Nr 4, 2000, f. 29-45, teksti i plotë i Rekomandimeve të Lundit shfaqet në shtojcë në nenin e lartpërmendur në f. 46-61

² Ibid, f. 64-67

³ Projekti u bë i mundur me kontributin bujar nga Agjencia Ndërkombëtare Kanadeze e Zhvillimit (CIDA).

Ndërkombëtar për Demokraci dhe Ndhimë Zgjedhore (International IDEA) dhe Zyrën e KLPK. Ato janë rezultat i bisedimeve të gjera⁴ dhe të dhënave nga ekspertët⁵ në këtë sferë.

Është e rëndësishme të theksohet se udhëzimet nuk ju drejtohen të gjitha Lund Rekomandime - vetëm atyre që kanë të bëjnë me punën e ODIHR-it lidhur me zgjedhjet.

⁴ Një dokument diskutimi në formën e udhëzimeve të draftit është përgatitur nga Peter Harris dhe Halton Cheadle në emër të International IDEA. Drafti ishte objekt i diskutimeve intensive dhe të dhënave nga ekspertët e mbledhur nga ODIHR-i në një seminar të mbajtur në 3-4 korrik të vitit 2000 në Varshavë. Një draft tjetër është përgatitur dhe shqyrtohet përsëri nga ODIHR-i, Zyra e Komisionarit të Lartë për Pakica kombëtare dhe ekspertëve të pavarur para se të finalizohet.

⁵ Ekspertët ishin: Dr Vojin Dimitrijević, Drejtor i Qendrës së Beogradit për të Drejtat e Njeriut, Republika Federale e Jugosllavisë, Dr Yolanta Hristova, Ekspert për të Drejtat e Pakicave, Misioni i OSBE në Kroaci; Dr Jessie Pilgrim, Konsulent ligjor, SHBA; Dr Aleksander Postnikov, Hulumtues, Instituti i Legjislacionit dhe Ligjit Krahasues, Federata Ruse, Dr Andrew Stephen Reynolds, Asistent Profesor, Universiteti i Notre Dame, SHBA, Dr Timothy Sisk, Bashkëpunëtor i lartë për hulumtime, diplomuar Shkolla Shqiptare e Studimeve Ndërkombëtare, Universiteti i Denverit, SHBA, dhe Mark Stevens, Drejtor i Programit, Shërbimet Ndërkombëtare për Reformat zgjedhore, Mbretëria e Bashkuar

2.

SFONDI (HISTORIA) E LUND REKOMANDIMEVE

KLPK është mekanizmi kryesor i OSBE-së për parandalimin e konflikteve lidhur me pakicat. Si një instrument për parandalimin e konflikteve për të vepruar në fazën më të hershme, KLPK punon ngushtë me qeveritë dhe grupet e pakicave për të siguruar se politikat e qeverisë respektojnë standardet ndërkombëtare në këtë sferë dhe miratohen praktika efektive.

KLPK ka identifikuar çështje të caktuara aktuale që janë bërë objekt i vëmendjes së tij në lidhje me potencialin e tyre për konflikt brenda shteteve. Në veçanti, edukimi dhe përdorimi i gjuhës janë identifikuar si burimet potenciale të konfliktit brenda Shteteve anëtare të OSBE-së. Në mënyrë që të zhvillojë politika të përshtatshme të qeverive në lidhje me këto dy çështje, KLPK ka përpiluar dy komplete të rekomandimeve që shërbejnë si referenca për politikë-

bërësit dhe ligjdhënësit në ato shtete. Këto rekomandime janë:

- ▶ Rekomandimet e Hagës lidhur me të Drejtat e Arsimit të Pakicave Kombëtare (1996);⁶
- ▶ Rekomandimet e Oslos lidhur me të Drejtat Gjuhësore të Pakicave Kombëtare (1998).⁷

Në vitin 1998, KLPK ka identifikuar një burim të tretë të konfliktit potencial: pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në qeverisjen e shteteve. Në mënyrë që të marrë pikëpamjet dhe përvojat e Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së në këtë fushë, KLPK dhe ODIHR-i organizuan një konferencë me të gjitha shtetet anëtare të OSBE-së dhe organizatave të caktuara ndërkombëtare të quajtur “Qeverisja dhe Pjesëmarrja: Integrimi i Diversitetit.”⁸ Deklarata e Kryetarit të Konferencës vuri në dukje:

⁶ Për tekstin e plotë të Rekomandimeve të Hagës, së bashku me disa analiza shkencore, shiko çështjet e veçanta në Gazetën Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Pakicave dhe Grupeve, Vëllimi 4, nr 2, 1996/97

⁷ Për tekstin e plotë të Rekomandimeve të Oslos, së bashku me disa analiza shkencore, shiko çështjet e veçanta në Gazetën Ndërkombëtare mbi të Drejtat e Pakicave dhe Grupeve, Vëllimi 6, nr 3, 1999

⁸ Konferenca u mbajt në Lokarno në tetor 1998, organizuar nga Konfederata zvicerane

“Dëshira për ‘aktivitetet konkrete vijuese’ duke përfshirë përpunimin e mëtejshëm të koncepteve të ndryshme dhe mekanizmave të qeverisjes së mirë me pjesëmarrjen efektive të pakicave, që çon në integrimin e llojllojshmërive në shtet!”

Si rezultat i Deklaratës së Kryetarit, Qeveria e Suedisë ofroi të financojë një grup ekspertësh të pavarur që të takohen në Lund, Suedi, të përgatisin rekomandimet mbi pjesëmarrjen efektive të pakicave kombëtare në qeverisjen e shteteve demokratike. Këto rekomandime janë të njohura si “Rekomandimet e Lundit”. Qëllimi i Rekomandimeve të Lundit, si edhe Rekomandimet e Hagës dhe Oslos, është të inkurajojë shtetet anëtare të OSBE-së që të zvogëlojnë tensionet, përmes miratimit të masave të veçanta, lidhur me pakicat kombëtare dhe, me këtë, ti shërbejnë qëllimit përfundimtar të KLPK për parandalimin e konflikteve.

Premisat themelore të Rekomandimeve të Lund-it janë:

- ▶ Shtetet do të respektojnë dhe zbatojnë obligimet e të drejtave të njeriut, në veçanti, lirinë nga diskriminimi;
- ▶ Qëllimi i instrumenteve të drejtave të njeriut është të sigurojnë zhvillimin e plotë dhe të lirë të personaliteti të njeriut në kushtet e barazisë;
- ▶ Qëllimi i qeverisjes së mirë demokratike është që t’ju shërbejë nevojave dhe interesave të të gjithë atyre që jetojnë dhe banojnë në atë vend; dhe
- ▶ Qeverisja e mirë demokratike do të lejojë, inkurajojë dhe mbështet të gjithë ata që janë subjekt i vendimeve të tij për të marrë pjesë në marrjen e këtyre vendimeve.

3.

RËNDËSIA E PROCESIT

Këto udhëzime janë përpiluar për të ndihmuar edhe qeveritë edhe organizatat që përfaqësojnë ose mbështesin pakicat kombëtare. Ndihma është e drejtuar drejt përpilimit të një kornize ligjore për një sistem zgjedhor që siguron pjesëmarrje efektive të pakicave kombëtare në jetën publike. Për të bërë këtë janë cituar shembuj të ndryshëm të praktikave të mira në disa vende të caktuara. Këta shembuj nuk kanë për qëllim të jenë të zgjeruar ose gjithëpërfshirës, dhe asnjë konkluzion nuk duhet të nxirret nga shembujt lidhur me shtetet që janë përmendur ose të cilat nuk përmenden.

Procesi i dezenimit dhe modifikimit të sistemeve zgjedhore dhe krijimit të institucioneve zgjedhore është kritik për suksesin dhe qëndrueshmërinë e atyre sistemeve dhe institucioneve. Procesi do të ndikojë dukshëm në cilësinë e rezultatit. Një proces përfshirës ndihmon për të kontribuar në legjitimitetin e rezultateve. Ai ofron mundësi për të debatuar opsionet e

hapura për pakicat kombëtare dhe ndjek alternativat për akomodimin e interesave dhe nevojave të tij.

Me qëllim që të ndihmojmë politikëbërësit dhe vendimmarrësit, janë identifikuar për shqyrtim çështjet dhe parimet kryesore të procesit:

- ▶ Një proces formal është më i mirë se një proces ad hoc;
- ▶ Sa më shumë përfshirës është procesi aq më mirë është. Kjo nuk duhet vetëm ti referohet partive politike por, gjithashtu, edhe shoqërisë civile. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për të siguruar që gratë të marrin pjesë plotësisht në proces;
- ▶ Është thelbësore të ndërtohet besimi dhe legjitimiteti ndaj procesit. Kjo përfshin:
 - Sigurim se të gjitha palët e interesuara janë të përfshira dhe marrin pjesë në hartimin e vetë procesit;⁹

⁹ Kjo mund të arrihet përmes formave të ndryshme të konsultimit, të cilat do të përfshijnë votimet, referendumet, negociatat, forumet për konsensus ose organet dhe komisionet e punës

-
- Të merret parasysh emërimi i lehtësuesve neutral dhe legjitim. Në disa negociata, ishin të angazhuar juristë të respektuar gjerësisht;¹⁰
 - Informata duhet të ndahet sa mund e më gjerë;¹¹
 - ▶ Është e nevojshme për të siguruar që është dhënë kohë e mjaftueshme për procesin;
 - ▶ Është e rëndësishme për të gjitha palët:
 - Të shmangin krijimin e parakushteve ose vënien e pengesave për pjesëmarrje;
 - Të njohin nevojën për fleksibilitet;
 - ▶ Është e rëndësishme të sigurohet që procesi është i financuar. Të gjitha palët në këtë proces duhet të kenë burimet e nevojshme për të marrë pjesë plotësisht në të, dhe asnjë palë ose asnjëra prej palëve nuk duhet të gëzojë avantazh të padrejtë.

¹⁰ Në Irlandën Veriore, senatori Mitchell i Shteteve të Bashkuara i kryesoi bisedimet e paqes. Në Afrikën e Jugut, dy gjykatës kryesuan bisedimet e paqes

¹¹ Roli i mediemeve në lidhje me publikimin dhe shpërndarjen e informatave është kritik. Qasja e barabartë dhe transparente deri te informatat, veçanërisht në lidhje me çështjet e pakicave, është e rëndësishme

4.

KORNIZA LIGJORE NDËRKOMBËTARE

Standardet vijuese ndërkombëtare formojnë bazën normative edhe për Rekomandimet e Lund-it edhe për këto udhëzime:

- ▶ Neni 21 (3) i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut që thekson se "dëshira e popullit do të jetë baza e autoritetit të qeverisë";
- ▶ Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR) garanton të drejtat dhe liritë e mëposhtme:¹²
 - E drejta e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë dhe shfaqjes të këtyre besimeve (neni 18);
 - E drejta e mendimit pa ndërhyrje dhe lirisë për të shprehur këto mendime (neni 19);
 - E drejta e tubimit paqësor (neni 21);
 - E drejta e lirisë për tu shoqëruar (neni 22);
- E drejta dhe mundësia, pa dallim të çdo lloji, si raca, ngjyra, gjinia, gjuha, besimi fetar, mendimi politik ose mendimi tjetër, origjina kombëtare ose sociale, pasuria, lindja ose statuseve të tjera:
 - ▶ Për të marrë pjesë në kryerjen e punëve publike, drejtpërdrejt ose me anë të përfaqësuesit lirisht të zgjedhur;
 - ▶ Për të votuar dhe për tu zgjedhur në zgjedhje periodike që do të zbatohen me të drejtën e përgjithshme dhe të barabartë për të votuar dhe do të mbahet me votim të fshehtë; dhe
 - ▶ Të kenë qasje në kushte të përgjithshme të barazisë në shërbimet publike të atij shteti (neni 25).
- E drejta për mbrojtje të barabartë dhe efektive nga ligji kundër diskriminimit në çdo bazë të tilla

¹² Duhet të theksohet se, përveç kufizimeve të lejueshme prej disave të drejta të caktuara, Neni 5 (1) i KNDKP parashikon se, "Asgjë në këtë Pakt nuk mund të interpretohet sikur i implikon ndonjë Shteti, grupi apo personi, çfarëdo të drejte për t'u angazhuar në çfarëdo aktivitet ose të kryejë çdo akt që synon kufizimin e tyre në masë më të madhe se sa që është e parashikuar në Konventën aktuale".

- siç janë raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose mendimi tjetër, origjina kombëtare ose sociale, pasuria, lindja ose ndonjë status tjetër (Neni 26).
- ▶ Neni 2 i Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (CERD) parashikon: “Shtetet anëtare do të dënojnë diskriminimin racor dhe do të angazhohen për të ndjekur me të gjitha mjetet e përshtatshme dhe pa vonesë politikën e eliminimit të diskriminimit racor në të gjitha format e tij dhe promovimin e mirëkuptimit midis të gjitha racave, dhe, në këtë aspekt:
 - (a) Secili Shtet anëtar merr përsipër të mos angazhohet në asnjë veprim ose praktikë të diskriminimit racor kundër personave, grupeve të personave ose institucioneve dhe të sigurojë që të gjitha autoritetet publike dhe institucionet publike, kombëtare dhe lokale, të veprojnë në përputhje me këtë detyrim;
 - (b) Secili Shtet anëtar merr përsipër të mos sponsorojë, mbrojë ose mbështesë diskriminimin nga cilido person ose organizatë;
 - (e) Secili Shtet anëtar merr përsipër të inkurajojnë, kur është e përshtatshme, organizatat dhe lëvizjet integruese multi- raciale dhe mjetet e tjera për eliminimin e barrierave mes racave, dhe për të shkurajuar çdo gjë që ka tendencë për të forcuar ndarjen racore.”
 - ▶ Neni 5 i CERD-it thekson: “Në përputhje me detyrimet themelore të parashtruara në nenin 2 të kësaj Konvente, Shtetet anëtare angazhohen të ndërmarrin ndalimin e rreptë dhe eliminimin e diskriminimit racor në të gjitha format e tij dhe të garantojnë të drejtën e të gjithëve, pa dallime siç janë raca, ngjyra, origjina kombëtare ose etnike, për barazi para ligjit, veçanërisht në gëzimin e të drejtave të mëposhtme:
 - ...
 - (b) të drejtat politike, në veçanti të drejtën për të marrë pjesë në zgjedhje - për të votuar dhe për tu zgjedhur në bazë të së drejtës së përgjithshme dhe të barabartë për të votuar, për të marrë pjesë në Qeveri, si dhe në kryerjen e punëve publike në çdo nivel dhe të kenë qasje të barabartë në shërbimet publike;
 - (d) të drejtat e tjera civile, në veçanti:...
 - (vii) të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe besimit;
 - (viii) të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes;
 - (ix) të drejtën e lirisë së mbledhjes dhe shoqërimit paqësor.
 - ▶ Neni 2 i Deklaratës së KB mbi të Drejtat e Personave që u takojnë Pakicave Kombëtare ose Etnike, Fetare ose Gjuhësore thekson se:
 - (2) Personat që u përkasin pakicave kanë të drejtë të marrin

pjesë në mënyrë efektive në jetën kulturore, fetare, sociale, ekonomike dhe publike;

- (3) Personat që u përkasin pakicave kanë të drejtë të marrin pjesë në mënyrë efektive në vendimet në nivel kombëtar dhe, kur është e përshtatshme, në nivel rajonal lidhur me minoritetin të cilit ata i përkasin apo rajonit në të cilin ata jetojnë, në një mënyrë që nuk është jokompatible me legjislacionin kombëtar;
- (4) Personat që u përkasin pakicave kombëtare kanë të drejtë të themelojnë dhe të mbajnë shoqatat e tyre;
- (5) Personat që u përkasin pakicave kombëtare kanë të drejtë të themelojnë dhe mbajnë, pa asnjë diskriminim, kontakte të lira dhe paqësore me anëtarë të tjerë të grupit të tyre dhe me personat që u përkasin pakicave të tjera, si edhe kontaktet me qytetarët përtej kufijve të shteteve të tjera për të cilin ata janë lidhur me lidhje kombëtare apo etnike, fetare ose gjuhësore.
- ▶ Neni 15 i Konventës Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare thekson:

“Shtete anëtare do të krijojnë kushte të nevojshme për pjesëmarrje efektive të personave që u takojnë pakicave kombëtare

në jetën kulturore, sociale dhe ekonomike dhe çështjet publike, në veçanti ato që ndikojnë mbi ta”.

- ▶ Paragrafët 5 dhe 6 të Dokumentit të Kopenhagës Mbledhja e Konferencës mbi Dimensionin Njerëzor të KSBE (Dokumenti i Kopenhagës) specifikon se “në mesin e atyre elementeve të drejtësisë që janë thelbësore për shprehjen e plotë të dinjitetit të lindur të të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjithë qenieve njerëzore ... vullneti i popullit, shprehur lirisht dhe në mënyrë të drejtë përmes zgjedhjeve të rregullta dhe korrekte, është baza e autoritetit dhe legjitimitetit të të gjitha qeverive”.
- ▶ Paragrafi 35 i Dokumentit të Kopenhagës kërkon që Shtetet anëtare të OSBE-së të “respektojnë të drejtën e personave që ju takojnë pakicave kombëtare për pjesëmarrje efektive në çështjet publike, përfshirë pjesëmarrjen në çështjet që lidhen me mbrojtjen dhe promovimin e identitetit të pakicave të tilla.” Po ashtu, ligji ndërkombëtar parashikon disa kufizime të rëndësishme për liritë dhe të drejtat e theksuara më lart.¹³ Kjo përfshin Nenin 4 të CERD, i cili thotë:

“Shtetet anëtare dënojnë të gjitha propagandat dhe të gjitha organizatat të cilat janë të bazuara në ide ose teori të

¹³ Përveç kufizimeve të lejueshme për liritë dhe të drejtat e theksuara më lart, është e rëndësishme të kujtojmë se aty janë edhe ndalimet e veçanta që mund të jenë relevante, siç janë neni 20 i ICCPR (ndalojnë “propagandë për luftë” dhe “qdo thirrje për urrejtje nacionale, racore dhe fetare që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi apo dhunë”) dhe neni 6 (2) i Konventës Kornizë mbi Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (që kërkon prej shteteve anëtare të marrin masa për të mbrojtur personat kundër diskriminimit, armiqësisë apo dhunës).

superioritetit të një race ose grupi personash të një ngjyre ose origjinë etnike, apo të cilat përpiqen të justifikojnë ose promovojnë urrejtjen racore dhe diskriminimin e cilës do forme, dhe të ndërmarrin miratimin e masave të menjëhershme dhe pozitive të përpiluara për të çrrënjësuar të gjitha nxitjet për të, apo aktet e diskriminimit të tillë dhe, për ta arrit këtë, me një respektim të duhur të parimeve të mishëruara në Deklaratën Universale e të Drejtave të Njeriut dhe të drejtat e parapara shprehimisht në nenin 5 të kësaj Konvente, në mes tjerash:

(a) do të deklarojë si vepër penale të dënueshme me ligj të gjitha përhapjet e ideve të bazuara në superioritetin ose urrejtjen racore, nxitjen e diskriminimit racor, si

dhe të gjitha aktet e dhunës ose të nxitjes për akte të tilla kundër çdo race ose grupi të persona ngjyrës ose origjinës etnike tjetër, si dhe ofrimin e çdo ndihmë për aktivitetet raciste, duke përfshirë financimin e tyre;

(b) do të deklarojë të paligjshme dhe ndalojë organizatat, dhe gjithashtu të gjitha aktivitetet e tjera të organizuara të propagandës, të cilat promovojnë dhe nxisin diskriminimin racor, dhe do të shpallin si një vepër e dënueshme me ligj pjesëmarrjen në organizata ose aktivitete të tilla;

(c) nuk do të lejojnë autoritetet publike ose institucionet publike, kombëtare ose lokale, të promovojnë ose nxisin diskriminim racor”

5.

REKOMANDIMET E LUNDIT PËR ZGJEDHJET: NR. 7

“Përvoja në Evropë dhe gjetiu tregon rëndësinë e procesit zgjedhor për lehtësimin e pjesëmarrjes së pakicave në sferën politike. Shtetet duhet të garantojnë të drejtën e personave që ju takojnë pakicave kombëtare për të marrë pjesë në kryerjen e punëve publike, përfshirë edhe të drejtën e votimit dhe kandidimin për post pa diskriminim”.

5.1 Shpjegimi i përmbajtjes

Prej Shteteve anëtare kërkohet që të garantojnë të drejtat e personave që ju takojnë pakicave kombëtare për të marrë pjesë në jetën publike. Kjo garanci do të mishërohet më mirë duke përfshirë të drejtën në kushtetutë. Kushtetuta duhet ta përforcojë të drejtën.¹⁴ Ajo duhet gjithashtu të specifikojë kushtet nën të cilat legjislatura mund të kufizojë

këta të drejta. Për shembull, Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike ju lejon shteteve që të kufizojnë të drejtat civile dhe politike në mënyrë që të mbrojnë të drejtat e tjerëve, të garantojë sigurinë kombëtare ose për të mbajtur rendin publik.¹⁵

Ekzistojnë dy aspekte për të drejtën për të marrë pjesë në jetën publike, të cilat kërkojnë përpunim më të detajuar. Ata janë:

¹⁴ Ekzistojnë formula të ndryshme për përforcimin e të drejtave të mbrojtura me Kushtetutë: shih, për shembull, përfshirjen e Deklaratës së të Drejtave të Njeriut në Kushtetutën e Francës të vitit 1789 në Preambulën e asaj Kushtetute; të Drejtat Themelore në nenet 1 deri 19 i Kushtetutës gjermane; Amendamentet I deri në X, XIII deri në XV, XIX, XXIV dhe XXVI të Kushtetutës amerikane; Karta kanadeze e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, e cila formon Pjesën e I-rë të Aktit të Kushtetutës kanadeze; Qëllimet dhe Direktivat Kombëtare Parimet dhe Detyrimet Sociale themelore në Kushtetutën e Papua Guinea e Re; dhe të Drejtat Themelore në Pjesën III të Kushtetutës indiane; Banorët e Luksemburgut dhe Drejtat e tyre, në Kapitullin II të Kushtetutës të Luksemburgut; Parimet Fundamentale në nenet 1 deri 11 i Kushtetutës italiane; të Drejtat Themelore në Kapitullin 1 të Kushtetutës holandeze; Nenet 40 - 44 të Kushtetutës irlandeze; Kapitullin 2 të Instrumentit të Qeverisë suedeze; Pjesa I e Kushtetutës spanjolle; neni 8 dhe Kapitulli XII i Kushtetutës hungareze, etj.

¹⁵ Për më tepër: dispozita të veçanta për kufizim të bashkangjitura me secilën drejtë në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të drejtat themelore të ndryshme në Kapitullin 1 të Kushtetutës holandeze. Për shembuj të klauzolave për kufizime të përgjithshme shiko: Neni 1 i Kartës Kanadeze i të Drejtave dhe Lirive, Neni 36 i Kushtetutës së Afrikës së Jugut; kufizimet në nenet 18, 18a dhe 19 të Kushtetutës gjermane; dhe nenet 12 deri 14 të Instrumentit të Qeverisë suedeze.

- ▶ Grup i të drejtave individuale që garantojnë pjesëmarrjen në zgjedhje dhe në jetën publike; dhe
- ▶ E drejta për mos tu diskriminuar në ushtrimin e këtyre të drejtave, për shkak se personi i përket ndonjë pakice kombëtare.

5.1.1 Të drejtat individuale për të marrë pjesë në zgjedhje

Ekziston një grup i të drejtave individuale që konsiderohen si thelbësore për themelimin dhe mirëmbajtjen e një demokracie. Ata shtrihen nga e drejta për të formuar shoqata politike dhe shoqata të tjera deri te e drejta për të bërë fushatë, kandidimi për post dhe për të votuar. Të drejtat vazhdojnë edhe përtej të drejtave të votuesve individual deri te të drejtat e partive politike dhe shoqata të tjera për të fituar mbështetje dhe për fushatë.

Ky grup ndahet zakonisht në këto të drejta specifike:

- ▶ E drejta për të votuar, në veçanti e drejta për votim të fshehtë;
- ▶ E drejta për zgjedhje të rregullta dhe korrekte;
- ▶ E drejta për tu kandiduar për funksione publike;
- ▶ Liria e shoqërimit;
- ▶ Liria e tubimit;
- ▶ Liria e shprehjes.

Këto të drejta duhet të jenë të garantuara me kushtetutë. Megjithëse kushtetutat në përgjithësi ju lejojnë legjislaturave ti kufizojnë këto të drejta, këto kufizime duhet të jenë shqyrtuar me kujdes për të siguruar që nuk janë në shkelje të standardeve ndërkombëtare dhe, përgjithësisht, nuk ndikojnë në pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në jetën publike.

Shembuj të kufizimeve problematike janë:

- ▶ Përcaktimi i kërkesës gjuhësore për funksionet publike;
- ▶ Kërkesat e tepruara për regjistrimin e partive politike;
- ▶ Kërkesa për shpërndarje që detyron partitë apo kandidatët që të kandidohen në një numër të krahinave apo qarqeve ose madje edhe t'i detyrojnë ata të kenë një zyrë në çdo krahinë nëse kjo ka efektin e diskriminimit ndaj pakicave kombëtare.

E drejta për të votuar

- ▶ E drejta për të votuar e parashikuar sipas këtij kapitulli është e drejta e përgjithshme për të votuar. Disa shtete ju sigurojnë personave të pakicave kombëtare një votim shtesë.¹⁶ E drejta për votim shtesë është zakonisht një çështje që duhet të merren parasysh në forma të ndryshme për përfaqësimin e pakicave dhe pjesëmarrje në jetën

¹⁶ Për shembuj të shteteve të ndryshme se si ato i kënaqin pakicat kombëtare shih: Artikuj 32B dhe 68 të Kushtetutës hungarez; Kanada (neni 23 i Kartës Kanadeze të të Drejtave dhe Liritë (shih Fusnota 7 më sipër), i cili mbron të drejtat arsimore në gjuhën e pakicave dhe Nenet 53 dhe 55 të Kushtetutës spanjolle

publike. Ata çështje janë trajtuar në Paragrafin 7 më poshtë.

- ▶ Edhe pse është e zakonshme për kushtetutat të kufizojnë të drejtën e votimit për qytetarët, ky kufizim mund të përbëjë një burim të konfliktit në lidhje me shtetet që kanë pakica kombëtare ose popullsi të madhe të përbërë nga jo-shtetasit nëse janë të ngërthyera në mënyrë që diskriminon pakicat kombëtare. Ka shumë shkaqe për këtë konflikt potencial. Ata mund të jenë nga mënyra në të cilën kërkesat për shtetësi janë përcaktuar me ligj (për shembull, kufizimi i shtetësisë të ndonjë grupi etnik duke e bërë administrativisht vështirë të bëhet shtetas). Në thelb, shtetësia nuk duhet të përdoret në mënyrë që të diskriminojë personat që ju takojnë pakicave kombëtare.
- ▶ Kriteret e përshtatshmërisë për regjistrimin si votues mund të kenë pasoja për pakicat kombëtare. Kufizimi i të drejtës për të votuar për banorët e një zone zgjedhore do ndikojë negativisht në popujt nomad. Përfshirja apo përjashtimi i votuesve të jashtëm mundet gjithashtu të ndikojë negativisht në pjesëmarrjen e pakicave kombëtare.

E drejta për zgjedhje të rregullta dhe korrekte (të ndershme)

- ▶ Zgjedhjet nuk duhet vetëm të jenë të rregullta, por duhet gjithashtu të mbahen në intervale të arsyeshme. Në shumicën e kushtetutave, zgjedhjet mbahen midis 2 deri në 5 vjet.

- ▶ E drejta për votim të fshehtë është thelbësore për zgjedhje korrekte. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në shoqëritë me pakica kombëtare. Vijon se shteti duhet të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme për të siguruar që votuesit që ju përkasin pakicave kombëtare të besojnë se votat e tyre janë të fshehta. Në këtë aspekt, duhet theksuar Paragrafi 7.4 i Dokumentit të Kopenhagës, i cili detajon se shtetet pjesëmarrëse do të "Sigurojnë që votat janë të hedhura me votim të fshehtë ose sipas procedurës ekuivalente të votimit të lirë...."
- ▶ Zgjedhjet duhet të zbatohen në mënyrë korrekte. Ka dy aspekte për këtë të drejtë. Zgjedhjet nuk duhet vetëm të zbatohen në mënyrë korrekte, por gjithashtu duhet të perceptohen se janë të tilla. Legjitimiteti i procesit zgjedhor është veçanërisht i rëndësishëm në shoqëritë me tensione etnike dhe nivel të lartë të mosbesimit.
- ▶ Ka mënyra të ndryshme institucionale dhe procedurale me të cilat shtetet mund të sigurojnë se zgjedhjet janë zhvilluar në mënyrë korrekte. Opsionet e ndryshme shqyrtohen në paragrafin 7 më poshtë.

E drejta për tu kandiduar për post

- ▶ E drejta për tu kandiduar për funksione publike duhet të jetë e garantuar me Kushtetutë. Kufizimet mbi të drejtën duhet të shqyrtohen me kujdes në mënyrë që të sigurohet që personave që u përkasin

pakicave kombëtare nuk ju ndalohet mandati ose kandidimi për funksion. Derisa mund të caktohen rregulla për gjuhën për procedurat e institucioneve publike, duke përfshirë institucionet parlamentare, përjashtimi në bazë gjuhësore i cilit do person për tu kandiduar për funksion është në shkelje të nenit 25 të ICCPR dhe, thjesht, ndeshet me lirinë e votuesve për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre.¹⁷ Për shembull, kërkesa gjuhësore mund të ketë efekt të përjashtimit të kandidatëve nga pakicat kombëtare për kandidim për funksion.

Liria e shoqërimit

- ▶ Kjo liri është e rëndësishme për dy arsye. Ajo duhet të garantojë jo vetëm të drejtën për të formuar parti politike, por duhet gjithashtu të garantojë formimin e organeve të shoqërisë civile të tilla siç janë organizatat joqeveritare dhe organizatat kulturore që mund të mbështesin ose të përfaqësojnë pakicat kombëtare në një shoqëri.
- ▶ Koncepti për liri të shoqërimit ngërthen një numër të të drejtave plotësuese. Ato përfshijnë:
 - Të drejtën për të formuar parti politike apo shoqatë;
 - Të drejtën për t'ju bashkuar ndonjë partie politike apo shoqatë;
 - Të drejtën për të marrë pjesë në aktivitete të ligjshme të një

partie politike apo shoqate. Kjo e drejtë për të marrë pjesë duhet të shtjellohet që të përfshijë të drejtën e veçantë për tu tubuar dhe për fushatë në emër të ndonjë partisë politike.

- ▶ Shpesh është e mirë të përcaktohen këto të drejta në kushtetutë, në vend se ti lihen legjisllacionit të zakonshëm, rregulloreve ose përpunimeve nga gjykatat.
- ▶ Kjo e drejtë është kufizuar shpesh nga legjisllacioni. Këto kufizime duhet të shqyrtohen me kujdes në mënyrë që të sigurohet se ata nuk shkelin standardet ndërkombëtare ose nuk ndikojnë në mënyrë negative në pjesëmarrjen efektive të pakicave kombëtare në jetën publike.
- ▶ Drejta për vetë-identifikim për pakicat është e rëndësishme. Në këtë drejtim, praktika e imponimit të “përkatësisë etnike” mbi pakicat duhet të dekurajohet. Hungaria, në rastin e grupimit të pakicave është një shembull i mirë i të drejtës për vetë-identifikim, megjithëse gjithashtu kanë ekzistuar edhe probleme në rastin e Hungarisë. Zelanda e Re, me rastin e Maurëve, është një shembull tjetër i mirë.

Liria e tubimit

- ▶ Kjo liri është e lidhur ngushtë me lirinë e shoqërimit. Kjo është liri e rëndësishme në kontekst të

¹⁷ Ekzistojnë shembuj shumë mirë të njohur të përfaqësuesve të zgjedhur të cilët janë të paafte nga shikimi, dëgjimi ose të folurit. Sa më tepër, çdo kërkesë e tillë gjuhësore bëhet shumë problematike në lidhje me caktimin dhe testimin e aftësisë

zgjedhjeve për shkak se e drejta për të zhvilluar takime është pjesë fundamentale e politikës demokratike. E drejta shtrihet në të drejtën për protesta.

- ▶ Kjo liri duhet të jetë e garantuar me Kushtetutë. Kjo është liri që është normalisht subjekt i kufizimeve të tilla siç është mirëmbajtja e rendit publik. Megjithëse rendi publik përgjithësisht konsiderohet si një bazë e justifikueshme për kufizimin e kësaj të drejte, vështirësia e këtij kufizimi është në zbatimin e tij. Përcaktimi i asaj se kur mundet shteti të mbështetet në këtë bazë për të ndaluar ndonjë takim apo protestë ju është lënë shpesh funksionarëve shtetëror. Nëse nuk ka mbikëqyrje të shpejtë gjyqësore lidhur me këto vendime, në praktikë mund të shfuqizohet kjo liri.
- ▶ Kjo liri mund të dëmtohet nga praktika që partive politike apo shoqatave të tjera që përfaqësojnë pakicat kombëtare t'ju kufizohet lejimi i përdorimit të objekteve publike në dispozicion siç janë ndërtesa e komunës, etj.

Liria e shprehjes

- ▶ Kjo liri është një nga themelet e shtetit demokratik dhe është

fundamentale për të siguruar që pakicat kombëtare të marrin pjesë në mënyrë efektive në jetën publike. Më së miri është e garantuar në kushtetutën e shtetit. Qeveritë nganjëherë mundohen të justifikojnë kufizimet e kësaj lirie në bazë të sigurisë kombëtare. Këta kufizime duhet të jenë objekt i një kontrolli të rreptë për të siguruar vlefshmërinë dhe proporcionalitetin e kufizimit. Në veçanti, duhet të analizohet efekti i kufizimeve në pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në jetën publike.

- ▶ Detyra e shtetit për të garantuar lirinë e shprehjes në bazë të ligjeve ndërkombëtare ose të vendit nuk duhet të jetë e kufizuar në detyrimin negativ, p.sh., obligimi që të mos ndërhyjë ndaj lirisë. Ajo duhet të shtrihet për tu siguruar se pakicave kombëtare duhet tu jepet qasje e arsyeshme deri te mediumet në pronësi publike (të shtetit) për ti shprehur pikëpamjet e tyre.

5.1.2 Ndalimi kundër diskriminimit

- ▶ Të drejtat individuale për të marrë pjesë në jetën publike duhet të vlejnë për të gjithë personat pavarësisht nga origjina etnike ose kombëtare, gjuha ose feja. Këto të drejta duhet të aplikohen në mënyrë të barabartë.¹⁸ Diskriminimi nuk duhet

¹⁸ Marrëveshja për Mirëkuptim, Bashkëpunim dhe Fqinjësi të mirë midis Rumanisë dhe Republikës së Hungarisë ka të bëjë vetëm me pakicën hungareze; megjithatë, shumica e dispozitave të kësaj marrëveshjeje dypalëshe ka pasojat për pakicat e tjera në Rumani, gjithashtu. Neni 15.1 (a) konfirmon se Rumania ka ndërmarrë hapa që "në rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të personave që u takojnë pakicave kombëtare "të zbatojë" Konventën kornizë të Këshillit të Evropës në lidhje me pakicat kombëtare nëse "rregullimi i rendit të saj të brendshëm nuk përmban rregulla më të favorshme". Dispozitat e tjera lidhur me pakicat në Rumani në përgjithësi përfshijnë qasjen, dhe këmbimin e lirë të, informatave në gjuhën amtare (neni 15.4); të drejtën për të marrë pjesë në zgjidhjen e çështjeve me interes kombëtar apo lokal përmes përfaqësuesve të zgjedhur në organet e autoriteteve qendrore ose lokale publike (Neni 15.5); dhe respektin për trashëgiminë kulturore dhe historike të pakicave nacionale (neni 15.6).

të jetë me qëllim. Ai mundet të lind pa qëllim. Një kriter neutral mund të veprojë në rrethana të caktuara në mënyrë diskriminuese. Për shembull, banimi është kërkesë e përbashkët për kualifikim për të votuar në një sistem zgjedhor të bazuar në zonën zgjedhore. Kjo kërkesë mundet, megjithatë, të veprojë në mënyrë diskriminuese në lidhje me refugjatët (domethënë qytetarët ose banorët e përhershëm të shtetit që kanë ikur jashtë vendit), popujt nomade apo personat e zhvendosur brenda shtetit. Kërkesat për leje-qëndrim mund të jenë diskriminuese kundër pakicave kombëtare.

Kërkesa për përshtatshmëri për tu regjistruar si votues mund të ketë efekt diskriminues kundër personave që i përkasin një pakice kombëtare. Në vijim janë shembujt se si kërkesat e ligjshmërisë, në përgjithësi, mund të diskriminojnë kundër personave që u takojnë minoriteteve kombëtare:

- ▶ Shtetësia shpesh është kërkesë themelore për ligjshmërinë. Në përputhje me rrethanat, kërkesa për shtetësi ndikon në kualifikimin për të votuar. Më poshtë janë shembujt të llojeve të ndikimeve që mund të kenë ligjet që rregullojnë shtetësinë:
 - Në qoftë se përkatësia etnike është kërkesë për shtetësinë, ajo mund të diskriminojë kundër personave që u përkasin pakicave kombëtare që nuk i takojnë origjinës të njëjtë etnike;
 - Kërkesë për marrjen e shtetësisë që të dy prindërit duhet të jenë shtetas mund të veprojë

në mënyrë diskriminuese ndaj ndonjë pakicës kombëtare, veçanërisht asaj që ka qenë subjekt i zhvendosjen së kufijve kombëtar;

- Kufizimet mbi shtetësinë e dyfishtë mund të ndikojnë në mënyrë të dëmshme për pakicat kombëtare;
- ▶ Njohja rrjedhshëm e gjuhës zyrtare është një kërkesë që mund ta diskriminojë pakicën kombëtare që nuk e flet atë gjuhë;
- ▶ Shtetet nuk duhet të përshkruajnë apo nxjerrin jashtë ligjit përdorimin e cilësdo gjuhë në fushatat zgjedhore;
- ▶ Kërkesat për vendqëndrim mund të diskriminojnë pakicat kombëtare. Vendbanimi mund të veprojë në mënyrë diskriminuese ndaj refugjatëve ose personave të zhvendosur brenda vendit. Personat e zhvendosur brenda vendit duhet të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar; ku është e mundur, refugjatët duhet të gëzojnë disa lehtësime për të votuar.

Duhet të theksohet se, edhe pse e drejta për të marrë pjesë në jetën publike mund të sanksionohet në kushtetutë dhe në legjislacion, kjo është gjithashtu e nevojshme për të siguruar se nuk ka pengesa administrative apo pengesa të tjera për parandalimin e personave që ju takojnë pakicave kombëtare nga ushtrimi i plotë i të drejtave të tyre. Duhet të ndërmerren hapa për të siguruar që:

- ▶ Deri sa është e mundur, personat që u takojnë pakicave kombëtare të

- bëhen të vetëdijshëm në gjuhën e tyre për të drejtat e tyre për të marrë pjesë në jetën publike dhe se si këto të drejta mund të ushtrohen;
- ▶ Procesi i regjistrimit të votuesve është administruar në mënyrë të tillë që të sigurojë se personat që i përkasin pakicës kombëtare mund të regjistrohen pa vështirësi apo kosto materiale. Llojet e mëposhtme të çështjeve administrative janë të implikuar në bazë të këtij kreu:
 - Sa të jetë e mundur, formularët e regjistrimit dhe çdo dokumentacion shpjegues duhet të jetë në gjuhën e pakicës kombëtare;
 - Zyrat e regjistrimit duhet të jenë të vendosura dhe të hapura për regjistrimin në vende dhe në kohë që nuk e bëjnë të vështirë ose të kushtueshme për një person që të regjistrohet;
 - ▶ Është krijuar një klimë ku personat që i përkasin një pakice kombëtare mund të rekrutojnë, mbështesin, votojnë, dhe kandidohen për zyra dhe të marrin pjesë në jetën publike. Shteti duhet haptazi të dekurajojë diskriminimin dhe dhunën ndaj pakicave kombëtare dhe për të marrë aktiv hapa për parandalimin e diskriminimit dhe dhunës dhe të ndëshkojë autorët e këtyre veprave;
 - ▶ Pengesat nuk janë shumë të vështira, duke mos ju lejuar personave që të paraqiten si kandidatë ose të regjistrohen si parti politike, të tilla si shpenzimet e paarsyeshme, duke përfshirë edhe shqiptimin e depozitave të lartë;
 - ▶ Ligji për financimin e partisë politike nuk duhet të jetë diskriminues ose i padrejtë. Në veçanti çështja e financimit të jashtëm apo të huaj të partive politike apo të lëvizjeve të pakicave kombëtare nuk duhet të rregullohet në mënyrë që është diskriminuese;
 - ▶ Çfarëdo lloj financimi i partive politike nga fondet e shtetit duhet të jetë jo-diskriminues sa i përket diskriminimit ndërmjet grupeve të pakicave etnike apo kombëtare;
 - ▶ Mbledhja e nënshkrimeve nga kandidatët është e rregulluar në mënyrë apo formë që nuk i diskriminon në mënyrë të padrejtë grupet minoritare;
 - ▶ Kërkesat për të paraqitur kandidatë në një numër të caktuar të zonave të votimit apo rajoneve nuk janë diskriminuese;
 - ▶ Nuk duhet të ketë kufizim në fushatën në ndonjë gjuhë të veçantë;
 - ▶ Njohja rrjedhshëm e një gjuhe nuk duhet të përdoret si mundësi për tu regjistruar si votues ose për kandidim për funksionet publike;
 - ▶ Banimi jashtë vendit, veçanërisht në situatat post-konfliktuale, ku mund të ekziston një numër i konsiderueshëm i refugjatëve nga një grup minoritar, nuk duhet të përdoret si kriter i ligjshmërisë. Çështja e votimit të jashtëm është me rëndësi për atë që ajo mund të ndikojnë në të drejtat e pakicave.

5.2 Korniza ligjore dhe Opsionet

Ligji kombëtar duhet t'ju japë fuqi normave dhe standardeve ndërkombëtare. Është e preferueshme që e drejta për të marrë pjesë në jetën publike, pa diskriminim të përfshihet në kushtetutë dhe që ato dispozita të përforcohen në Kushtetutë. Ligjet zgjedhore duke i dhënë fuqi këtyre të drejtave duhet ti shpalosin detajet.

Të drejtat kushtetuese

Kushtetuta duhet të japë të gjithë personave të drejtën për të marrë pjesë në jetën publike pa diskriminim. Shtetet e ndryshme anëtare të OSBE-së tashmë sigurojnë kushte për këto të drejta në kushtetutat e tyre përkatëse:¹⁹

- ▶ E drejta e përgjithshme për të marrë pjesë në jetën publike. Për shembull:
 - Neni 70 i Kushtetutës së Hungarisë;
 - Neni 38 i Kushtetutës Gjermane;
 - Nenet 3 dhe 4 të Kushtetutës së Holandës;
 - Neni 39 i Kushtetutës së Republikës të Moldavisë;
- ▶ E drejta për mos tu diskriminuar në bazë të racës ose kombëtare, etnike ose origjinës sociale. Për shembull:
 - Neni 14 i Kushtetutës Spanjolle;
 - Neni 3 i Kushtetutës Gjermane;
 - Neni 70A e Kushtetutës së Hungarisë;

- Neni 16 (2) të Kushtetutës së Republikës të Moldavisë;
 - Neni 14 i Kushtetutës së Gjeorgjisë;
 - Neni 15 (3) të Kushtetutës së Republikës së Kirgistanit;
 - Neni 19 i Kushtetutës së Federatës së Rusisë;
- ▶ Drejta për të votuar. Për shembull:
- Neni 4 i Kushtetutës së Holandës;
 - Neni 16 i Kushtetutës së Irlandës;
 - Neni 70 i Kushtetutës së Hungarisë;
 - Neni 38 i Kushtetutës Gjermane;
 - Neni 1 (6) të Kushtetutës së Republikës së Kirgistanit;
 - Neni 49 (2) të Kushtetutës së Gjeorgjisë;
 - Neni 38 i Kushtetutës së Republikës së Moldavisë.

Përforcimet kushtetuese

Disa dispozita dhe të drejta të caktuara në kushtetutë mund të jenë aq të rëndësishme kështu që ata mund të kenë nevojë të përforcohen (fortifikohen). Dispozitat Kushtetuese mund të përforcohen në atë mënyrë që do të jetë e shumë më e vështirë që ndonjë ligj ta ndryshojë atë. Qëllimi i përforcimit kushtetues nuk është vetëm për të sinjalizuar karakterin themelor të dispozitave të përforcuara dhe zotimeve të kushtetutës për vlerat që përmbahen në ato dispozita, por edhe

¹⁹ Këto shembuj nuk janë të plota dhe nuk do të thotë se për shkak se këto të drejta janë të përfshira në kushtetutë që këto të drejta janë zbatuar. Dispozitat e kushtetutave janë që nga 15 gushti i vitit 2000.

për të dhënë siguri për përfituesit e këtyre dispozitave.

Përforcimet mund të marrin forma të ndryshme. Në këtë drejtim, një mekanizëm standard është të kërkohet rritja e pragut të votimit me ligj. Mekanizmat e tjerë mund të kërkojnë një procedurë të veçantë që duhet të ndiqet duke kërkuar angazhim me të

gjitha palët e interesuara relevante ose mbështetjen e shumicës për secilin ligj suplementar në sistemin federal të qeverisjes.

Përdorimi i referendumit ose plebishitit mund të jetë i përshkruar dhe shfrytëzuar në rastet që përfshijnë çështjet e të drejtave.

6.

REKOMANDIMETE LUND-it PËR ZGJEDHJET: Nr. 8

“Rregullimi i formimit dhe aktivitetit të partive politike duhet të përputhet me parimin e ligjit ndërkombëtar për lirinë e shoqërimit. Ky parim përfshin lirinë për të themeluar parti politike të bazuar në identitetet shoqërorë si dhe ata të cilat nuk identifikohen vetëm me interesat e një komuniteti të caktuar”.

6.1 Shpjegimi i përmbajtjes

Fjalja e parë e këtij rekomandimi është normative. Shtetet duhet të respektojnë parimet ndërkombëtare të lirisë së shoqërimit. Ky parim mund të gjendet i theksuar në standardet ndërkombëtare në vijim:

- ▶ Neni 22 i Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike;
- ▶ Neni 2 i Deklaratës së KB mbi të Drejtat e Personave që u takojnë Pakicave Kombëtare ose Etnike, Fetare ose Gjuhësore në mënyrë eksplicite thotë se personat që u takojnë këtyre pakicave kanë të drejtë të themelojnë dhe të mbajnë:
 - Shoqatat e tyre; dhe
 - Kontakte me anëtarët e tjerë të grupit të tyre edhe nëse ata janë shtetas të një shteti tjetër;
- ▶ Neni 11 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut;
- ▶ Neni 7 i Konventës Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (ETS Nr. 157, 1995) thekson se palët do të sigurojnë respekt për të drejtën e çdo personi që i përket ndonjë pakice kombëtare për lirinë e grumbullimit të qetë, liria e shoqërimit, lirinë e shprehjes dhe lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit;
- ▶ Paragrafi 7.6 i Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së: “respekton të drejtën e individëve dhe grupeve për të krijuar, në liri të plotë, partitë e tyre politike ose organizata të tjera politike dhe të siguron partive politike dhe organizatave të tilla garancitë e nevojshme ligjore për t’u mundësuar atyre të konkurrojnë

- me njëri-tjetrin në bazë të trajtimit të barabartë përpara ligjit dhe nga ana e autoriteteve”;
- ▶ Parimi ndërkombëtar parashikon se individët janë të lirë:
 - ▶ Të shoqërohen me cilin do person qoftë ai qytetar, banor, refugjat ose i huaj;
 - ▶ Të themelojë shoqatë;
 - ▶ Të përcaktojë qëllimet, definojë karakteristikat dhe rregullat e brendshme të shoqatës; dhe
 - ▶ Të vendosë, në baza jo-diskriminuese, se kush mund të bashkëngjitet dhe kush nuk mundet në shoqatë.²⁰
- Edhe pse shteteve ju është lejuar që të rregullojnë ushtrimin e lirisë për tu shoqëruar, shteti nuk mund të ndërhyjë në ta me përjashtim të rastit kur ndërhyrja është e justifikuar në bazë detyruese (imponuese). Edhe në ligjin ndërkombëtar edhe në ligjin krahasues kushtetues, çdo ndërhyrje me lirinë është rreptësisht e vëzhguar.²¹
- ▶ Ndërhyrja mund të justifikohet vetëm nëse:
 - ▶ Ndërhyrja është e përcaktuar me ligj;
- ▶ Ligji lejon ndërhyrje vetëm mbi arsyet e mëposhtme:
 - Siguria kombëtare;
 - Rendi publik dhe siguria;
 - Mbrojtja e shëndetit ose e moralit;
 - Mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tjerëve (siç përcaktohet në instrumentet ndërkombëtare e të drejtave të njeriut);
 - ▶ Ndërhyrja është e nevojshme në një shoqëri demokratike.
 - ▶ Kufizimet mbi shoqatat që promovojnë interesat e pakicave kombëtare janë bazuar normalisht në sigurinë kombëtare. Përveç nëse shoqata nxit përdorimin e dhunës në mënyrë që të arrijë qëllimet e saj, kufizimi nuk ka gjasa të jetë i justifikuar si një kërcënim për sigurinë kombëtare. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka theksuar vazhdimisht se po qe se nuk ekziston ndonjë thirrje për të përdorë dhunën ose aktet jodemokratike, shoqata e cila kërkon të ndryshojë strukturat ekzistuese të shtetit në mënyrë paqësore dhe demokratike, vetëm në këto kushte, nuk kërcënon sigurinë kombëtare.²² Fakti që një parti politike kërkon të

²⁰ Shteti është i detyruar, veçanërisht në bazë të nenit 2D dhe Nenit 5 të Konventës mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, të ndalojë anëtarët e shumicës të përjashtojnë personat që ju takojnë pakicave kombëtare që të marrin pjesë në shoqatat e krijuara nga anëtarët e shumicës. Shumica nuk mund të themelojë sindikata që janë të mbyllura për anëtarët e pakicave, as që munden organizatat profesionale të rregullohen ashtu që anëtarët e pakicave kombëtare të mos kenë qasje. I njëjti parim vlen edhe për shoqatat e themeluara nga pjesëtarët e pakicave. Shtetet duhet të ndalojnë përjashtimet mbi, për shembull, baza etnike ose kombëtare. Kështu, shoqatat e themeluara nga minoritetet për të promovuar kulturën e një pakice nuk mund të përjashtojnë një person që i përket grupeve të tjera nga anëtarësimi nëse ata dëshirojnë.

²¹ Shih, për shembull, qasjen e miratuar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në Sidiropoulos & të tjerët kundër Greqisë (57/1997/841/1047) në të cilin Gjykata thekson që "përjashtimi prej lirisë për tu shoqëruar duhet të interpretohet ngushtë", në paragrafin 38.

- ▶ Nevojë për përmirësimin e trajnimit në aspektet ligjore, pajtimin, dhe administrimin e drejtësisë zgjedhore;
- ▶ Nevojë për zgjedhjen e personelit të paanshëm dhe profesional për të administruar dhe ekzekutuar sistemin e drejtësisë zgjedhore.

Komponenti i dytë është rëndësia e të pasurit të organit përkatës të pavarur dhe/ose neutral për të siguruar zbatimin e duhur, i cili do të garantojë përfundimisht që dispozitat dhe përcaktimet për pakicat kombëtare nuk do të bëhen vetëm dispozita në “letër”.

Në këtë drejtim, organi kryesor në lidhje me zbatimin e ligjeve zgjedhore, sistemeve dhe administratës do të jetë administrata zgjedhore apo komisioni zgjedhor në një shtet të caktuar. Në mënyrë që të ndërtojë besimin dhe të inkurajojë pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në zgjedhje, anëtarët e pakicave duhet të përfshihen në komisionet zgjedhore.

9.1 Opsionet e Organit Zgjedor

Pasi që tanimë funksionet dhe tiparet e organit zgjedhor janë shqyrtuar, atëherë është e nevojshme të përcaktohet se ku duhet të vendoset ai organ. Për ta vënë në formën e tij më të thjeshtë, ka dy opsione konkurruese: brenda qeverisë ose jashtë qeverisë në një Komision zgjedhor. Gjithsesi, ekzistojnë dallime në këto dy opsione, bazuar në shumëllojshmërinë e fakteve dhe rrethanave, katër prej të cilave janë diskutuar më poshtë:

9.1.1 Qasja e Qeverisë

Modeli i parë është që organi zgjedhor të ndodhet brenda një ministrie të qeverisë dhe të jetë ngarkuar me përgjegjësinë e zbatimit dhe menaxhimit të zgjedhjeve dhe shfrytëzimin e burimeve të asaj ministrie dhe nëpunësve shtetëror për të përmbushur obligimin. Ky sistem funksionon mirë në rastet kur nëpunësit shtetëror janë të respektuar si profesionistë dhe politikisht neutral.

9.1.2 Qasje mbikëqyrëse ose gjyqësore

Një variacion i asaj më sipër është se ndonjë ministri e qeverisë është e ngarkuar me zbatimin e procesit zgjedhor, por është e mbikëqyrur nga një komision i pavarur zgjedhor i përbërë prej gjyqtarëve të zgjedhur. Detyra e komisionit është të mbikëqyrë dhe të monitorojë zbatimin e procesit zgjedhor nga ministria përkatëse e qeverisë. Kështu ndodh në Evropën Lindore dhe Qendrore në shtetet e tilla siç janë Shqipëria, Kroacia, Republika Çeke, Hungaria, Rumania dhe Sllovakia.

9.1.3 Qasja e Pavarur

Modeli i tretë është që të themelohet një komision i pavarur zgjedhor që është në mënyrë të drejtpërdrejtë përgjegjës para parlamentit apo komisionit parlamentar. Komisionet e pavarura zgjedhore duhet të kenë një shkallë të konsiderueshme të pavarësisë financiare dhe administrative nga dega ekzekutive e qeverisë. Procesi i përzgjedhjes për emërimin e komisionarëve të zgjedhjeve duhet të jetë transparent dhe i paanshëm. Në rastin ideal, zgjedhja duhet të bazohet në një konsensus të partive politike që konkurrojnë në zgjedhjet dhe të jenë individë me përvojë dhe ekspertizë përkatëse të cilët gjithashtu kanë një reputacion për pavarësi dhe integritet. Përdorimi i personave të njohur ndërkombëtarisht apo të shquar, i cili gjithashtu do të përfshijë anëtarë të shquar të shoqërisë civile, gjithashtu është dëshmuar si i suksesshëm në

shtetet ku ka pasur konflikt ose thyerja e besimit në mes të palëve.

9.1.4 Qasja e partive politike

Një alternativë tjetër në drejtim të krahasimit është që të gjitha partitë politike të kenë të regjistruara përfaqësuesit e emëruar në komisionin kombëtar të zgjedhjeve. Kjo siguron përfaqësimin e interesave të ndryshme në komision dhe që secila palë të ushtrojë një formë të mbikëqyrjes lidhur me funksionimin e komisionit. Problemi lidhur me këtë është se në situata të tranzicionit, numri i partive shtohet shpesh, duke rezultuar kështu me një komision kaba dhe të paefektshëm. Së dyti, komisioni mund të përbëhet nga individë që nuk posedojnë aftësitë dhe/ ose përvojën e nevojshme për të siguruar pjesëmarrje efektive në komision.

Në Evropën Lindore dhe Qendrore, në praktikisht të gjitha demokracitë e reja, zgjedhjet menaxhohen ose nga komisionet e pavarura (71 përqind) ose nga qeveria nën autoritetin mbikëqyrës (29 përqind), e cila zakonisht përfshin përfaqësues të partive politike.. Gjithsesi, duhet të theksohet se, edhe pse mund të ekzistojnë dispozita legjislative për pavarësinë dhe neutralitetin e komisioneve zgjedhore, në praktikë kjo shumë shpesh është vështirë të arrihet. Çështje të tilla si mënyra e emërimit dhe nga kush, si dhe financimi i komisioneve zgjedhore, janë aspekte të cilat e ulin vlerën dhe ndikojnë mbi pavarësinë ose neutralitetin e organit zgjedhor.

9.2 Përbërja e Komisionit apo Organit Zgjedhor

Është me rëndësi që në lidhje me përbërjen e komisionit apo organit zgjedhor, të ketë përfaqësim të përshtatshëm të pakicave kombëtare. Kjo do të zbatohet për të gjitha qasjet e detajuara më lartë, edhe pse do të ishte e vështirë të arrihet në qoftë se organi zgjedhor është vendosur brenda ministrisë të qeverisë. Pavarësisht nga kjo, nëse organi duhet të vendoset brenda ministrisë të qeverisë, atëherë duhet të ketë përfaqësim të mjaftueshëm dhe transparencë për të siguruar se jo vetëm që pakicat kombëtare luajnë një rol në vendimmarrje, por që të gjitha vendimet dhe arsyet përkatëse duhet të bëhen publike.

Kjo pjesëmarrje e pakicave, ku është e përshtatshme, në përbërjen e komisionit në nivel të lartë duhet të riprodhohet për të siguruar që ekziston pjesëmarrja e pakicave dhe përfaqësimin në secilin nivel të administratës zgjedhore, nga niveli kombëtare deri në nivelin lokal. Në komunitetet ku individët dhe votuesit do ndërveprojnë me përfaqësuesit e administratës zgjedhore, është veçanërisht e rëndësishme për grupet e pakicave të jenë të përfaqësuar dhe të përfshira në administratë. Përveç kësaj, parimet e transparencës dhe paanshmërisë janë të rëndësishme në shmangien e frikës dhe brengave të pakicës.

9.2.1 Transparenca

Besueshmëria e përgjithshme në procesin zgjedhor thellësisht varet nga të gjitha grupet relevante nga qeveria dhe shoqëria civile që marrin pjesë në formimin dhe funksionimin e strukturave dhe proceset zgjedhore. Në këtë drejtim, vlera e konsultimit të vazhdueshëm, komunikimit dhe bashkëpunimit midis administratës zgjedhore, partive politike dhe institucioneve të shoqërisë nuk mund të theksohet sa duhet. Në formimin e kuadrit ligjor të një administrate zgjedhore, ky aspekt duhet të fitojë një vëmendje të veçantë.

9.2.2 Paanshmëria

Funksionimi i një trupi zgjedhor nuk duhet të jetë subjekt i drejtimin nga ndonjë person, autoritet apo parti politike; ai duhet të funksionojë pa favorizim politik ose anshmëri. Organi përgjegjës për administrimin ose mbikëqyrjen e zgjedhjeve duhet të jetë në gjendje të veprojnë pa ndërhyrje, thjesht sepse çdo akuzë për manipulim, perceptim për anshmëri, ose ndërhyrje të dyshuara do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë jo vetëm në besueshmërinë e organit përgjegjës, por, në të gjithë procesin. Ka shumë raste në të cilat ndikimi i perceptuar i ndonjë partie ose partive mbi makinerinë zgjedhore ka lëkundur ashpër vlefshmërinë e rezultateve zgjedhore. Veçanërisht në demokracitë

në zhvillim dhe demokracitë e reja, ekziston shkallë shumë më e madhe e ndjeshmërisë ndaj dyshimeve të ndikimit të panevojshëm dhe anshmërisë, duke e bërë tërë procesin më të dyshuar për gjykime të besueshme, që pastaj në mënyrë të pashmangshme të rezultojnë në një pranim të kufizuar të rezultateve të zgjedhjeve dhe të procesit zgjedhor si një tërësi.

9.3 Organet zgjedhore të përhershme/ Ad Hoc

Duhet të vendoset se a thua komisioni zgjedhor duhet të jetë i përhershëm, i cili do të emërohet dhe do të veprojë në mënyrë të vazhdueshme, si kundërshtim i një organi ad hoc, që do të grumbullohet vetëm gjatë periudhës së zgjedhjeve dhe pastaj të shpërbëhet deri në veprimtarinë e ardhshme zgjedhore. Ekziston trendi ndaj organeve të përhershme zgjedhore, të

cilat ofrojnë administratë shumë më të qëndrueshme dhe efektive zgjedhore. Avantazhet e organit të përhershëm zgjedhor, veçanërisht lidhur me pakicat kombëtare, janë si vijojnë:

- ▶ Një organ i zyrtarëve të përhershëm dhe të përgjegjshëm të cilët janë të njohur për publikun dhe që krijojnë reputacion në sferën e zgjedhjeve;
- ▶ Ruajtje e aftësive profesionale nga zgjedhje në zgjedhje, si edhe memorien institucionale që është e nevojshme në këtë sferë;
- ▶ Aftësia e pakicave kombëtare për të bashkëvepruar me një grup të themeluar në mënyrë të duhur dhe të përhershme të individëve dhe profesionistëve;
- ▶ Aftësia e zyrtarëve zgjedhor për të bashkëvepruar ndërkombëtarisht dhe gjithashtu të sigurojnë që respektohen normat ndërkombëtare në lidhje me çështjet e pakicave.

Shtojca I

Listat kontrolluese

Lista kontrolluese e dispozitave kryesore për hartimin e sistemeve zgjedhore

	Çështja	Po	Jo
1	Cila është struktura e shoqërisë? A është e ndarë në aspektin etnik, fetar, gjuhësor ose në aspekt tjetër?		
2	A thua institucionet ekzistuese politike lehtësojnë menaxhimin e konfliktit dhe zgjidhjen e ankesave lidhur me çështjet e pakicave?		
3	Grupeve etnike a thua janë të përqendruara në një apo disa rajone të ndryshme? A thua grupet etnike janë përhapur në të gjithë vendin si një tërësi?		
4	A ekziston ndonjë konflikt mes grupeve të veçanta që mund të adresohet nëpërmjet projektimit të sistemit zgjedhor? Cili është burimi i këtij konflikti, p.sh., mbi resurset, territorin, të drejtat e grupit, etj?		
5	A thua projektimi i preferuar i sistemit zgjedhor në mënyrë adekuate do të përfaqësonte të gjitha grupet në parlament?		
6	A thua ndonjë grup ka gjasa të jetë në pozitë të pafavorshme nga projektimi i propozuar? A mund të sigurohet përfaqësimi i tyre në mënyra të tjera?		
7	Si do të ndikojnë sistemi zgjedhor në zhvillimin e sistemit të partive politike? A është e mundur të inkurajohet zhvillimi i partive multi-etnike?		
8	Atje ku ka përfaqësim të pakicave në legjislaturë, a ekzistojnë mekanizma për përfaqësimin e tyre efektiv?		
9	A ekzistojnë dispozita të veçanta që nxisin emërimet e pakicave në postet e shërbimeve publike?		
10	A ekziston prag numerik ose me përqindje që rrit ose zvogëlon mundësitë e përfshirjes së pakicave kombëtare në qeveri?		
11	A siguron sistemi ekzistues zgjedhor një lidhje të qartë në mes të disa ose të gjithë anëtarëve të zgjedhur dhe elektoratit të pakicave apo komunitetit?		
12	A thua sistemi zgjedhor inkurajon aleanca ndër-etnike?		
13	A janë partitë të inkurajuara të paraqesin kandidatë dhe lista të kandidatëve përfshirëse dhe me përbërje sociale të ndryshme?		

14	A tenton sistemi të promovojë modernizim dhe akomodim dhe zbutjen e rivalitetit etnik?		
15	A janë të lejuara partitë e vogla të bashkohen së bashku për qëllime zgjedhore por në të njëjtën kohë të mbetet entitete të ndara?		
16	A ka mandate të rezervuara ose kuotë për grupet e pakicave?		
17	A ka lista të kandidatëve etnikisht të përziera të detyrueshme?		
18	A është mekanizmi i mbi-përfaqësimi i grupeve të pakicave i përdorur për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre?		

Në varësi prej sistemit zgjedhor në vend, a thua kufijtë zgjedhor marrin në konsiderim ose parashikojnë:

	Çështja	Po	Jo
1	Kufizimet dhe objektet fizike/gjeografike të tilla siç janë lumenjtë, malet, rrugët, etj.		
2	Komunitetet e interesave		
3	Lehtësinë e qasjes nga ana e grupeve minoritare		
4	Identifikimin e ngushtë nga votuesit me përfaqësuesin e zgjedhur		
5	Shmangien e ndarjes dhe shpërndarjes së grupeve të pakicave në aspektin e ndikimit të votimit		
6	“Pavarësinë” dhe neutralitetin e atyre që janë ngarkuar të përpilojnë apo ndryshojnë kufijtë zgjedhor		
7	Mundësi për informata prej popullatës në procesin e rindarjes së kufijve të njësisve votuese		
8	Intervale midis versioneve të mëdha në kufijtë ekzistues		
9	Kriteret (përtej dhe mbi ato të përmendura më sipër) që ndikojnë në përcaktimin e vijave kufitare		
10	Që zonat zgjedhore të jenë relativisht të barabarta ose të barabarta në lidhje me popullsinë/ raportin gjeografik		
11	Nevoja për të dhëna të barabarta dhe të baraspeshuara nga të gjitha palët në qoftë se është e lejuar ndërhyrja politike		
12	Ekzistenca e përfaqësimit të pakicave, ose informimi zyrtar ndaj organit përgjegjës për përpilimin kufijve zgjedhor		
13	Shmangien e përcaktimit artificial të kufijve zgjedhor ose manipulimin e kufijve		
14	Të drejtat e refugjatëve dhe personave të zhvendosur		

Masat mbrojtëse për të adresuar frikën dhe shqetësimet e pakicave

	Çështja
1	Emërimi i një mekanizmi të pavarur për ankesat gjyqësore dhe për të siguruar emërimin e nivelin e nevojshëm të përfaqësimit të pakicave në organet gjyqësore
2	Disponueshmëria e mekanizmave të veçanta për ankesat/ apelet të përkushtuara për shqetësimet e pakicave
3	Emërimi i një "komitet të veçantë për demarkacion" përgjegjës para parlamentit dhe në të cilët janë të përfaqësuara pakicat kombëtare
4	Përfaqësimin e pakicave ose pjesëmarrja në një "komision për regjistrimin" për popullatën llogaritet si bazë për shënimin e zonave zgjedhore
5	Sigurimi që aspektet e tilla si financat dhe shpërndarja buxhetore për zgjedhjet të jenë transparente dhe në dispozicion të popullatës
6	Organet specifike për mbikëqyrje në të cilat minoritetet mund të jenë të përfaqësuara dhe që janë ngarkuar me përgjegjësi për të vëzhguar aspekte të tilla si përdorimi i burimeve të qeverisë dhe përdorimin e medimeve shtetërore, duke përfshirë kohën në TV dhe radio, etj.
7	Pjesëmarrjen e pakicave në hartimin e financave të fushatës dhe rregulloret e financimit të partive politike për të siguruar barazi
8	Përdorimi i komiteteve ndërlidhëse të partive politike brenda administratës zgjedhore për të siguruar se ekziston komunikim i vazhdueshëm dhe koordinim me partitë politike dhe veçanërisht grupet e pakicave kombëtare lidhur me shqetësimet e tyre dhe nevojat e veçanta zgjedhore.
9	Dispozita për vëzhguesit ndërkombëtar dhe vendor të zgjedhjeve në legjislacionin zgjedhor për të siguruar mbikëqyrjen dhe shqyrtimin e lirisë dhe korrektësisë së zgjedhjeve
10	Sigurimi se rregullat specifike/ direktivat janë lëshuar nga organi drejtues zgjedhor që mbështesin dispozitat kushtetuese dhe/ ose dispozitat ligjore lidhur me të drejtat e pakicave kombëtare.

Shtojca II

Sistemet Zgjedhore: Fjalori i shprehjeve

Vota Alternativa (AV) - Një sistem preferencial, pluralist – i shumicës i përdorur në zonat zgjedhore me një mandat të vetëm në të cilin votuesit përdorin numrat për të shënuar preferencat e tyre në fletëvotimin. Kandidati i cili fiton mbi 50 përqind të preferencave të para shpallet i zgjedhur. Nëse asnjë kandidat nuk fiton shumicën absolute të preferencave të parë, votat rivendosen deri sa një kandidat të ketë shumicën absolute të votave të hedhura.

Bllok i votave (BV) – Një sistem pluralist – i shumicës i përdorur në zonat zgjedhore me më tepër mandate në të cilën zgjedhësit kanë aq vota sa ka kandidatë për t'u zgjedhur. Votimi mund të jetë i bazuar në kandidatin ose në partinë politike. Numërimi është identik me sistemin i pari që kalon fiton postin, me kandidatin i cili ka më tepër vota në përgjithësi fiton postin.

Lista e mbyllur - Një formë e përfaqësimit proporcional në listën e zgjedhësve të cilat janë të kufizuara të votojnë vetëm për partinë dhe nuk mund të shprehin preferencë për ndonjë kandidat brenda listës së partisë.

I pari që kalon fiton postin (FPTP) - forma më e thjeshtë e sistemit zgjedhor pluralist – e shumicës, duke përdorur zonat zgjedhore me mandat të vetëm, fletëvotim kategorik dhe votim të orientuar ndaj kandidatit. Kandidati fitues është ai që fiton më shumë vota

se secili kandidat tjetër, por jo edhe domosdo shumicën e votave.

Lista e lirë - Një formë e listës së përfaqësimit proporcional që mundëson mbledhje ose grumbullim.

Vota e kufizuar – Një sistem pluralist – i shumicës i përdorur në zonat zgjedhore me më tepër mandate në të cilin votuesit kanë më shumë se një votë, por më pak vota se sa ka kandidatë për t'u zgjedhur. Numërimi është identik me sistemin i pari që kalon postin fiton, me kandidatët të cilët fitojnë numër më të madh të votave fitojnë mandatet.

Lista e përfaqësimit proporcional (Lista PR) - Në formën e saj më të thjeshtë, Lista PR përfshin secilën palë që dorëzon një listë të kandidatëve para votuesve, votuesit që votojnë për një parti, dhe partitë fitojnë mandatet në proporcion me pjesën e tyre të përgjithshme të votave kombëtare. Kandidatët fitues nxirren nga listat.

Shumica-pluralizmi (Sistemi me dy - raunde) – Në sistemin francez me dy raunde, secili kandidat i cili ka fituar mbi 12.5 përqind të votave të elektoratit të regjistruar në raundin e parë mund të kandidohet në raundin e dytë. Kushdo që fiton numrin më të madh të votave në raundin e dytë më pas shpallet si fitues, pavarësisht nëse ato kanë fituar shumicën absolute apo jo. Në pra i referohemi këtij sistemi si

sistemi i shumicës – pluralist me dy raunde.

Shumica - balotazhi (Sistemi me dy raunde) - Mënyra më e zakonshme për raundin e dytë të votimit në një sistem me dy raunde është konkurrimi i drejtpërdrejtë në “balotazh” mes dy kandidatëve që fitojnë numrin më të madh të votave në raundin e parë – këtë ne e quajmë sistemi i shumicës në balotazh.

Proporcional me anëtar të përzier (MMP) - Sistemet në të cilin një pjesë e parlamentit (zakonisht gjysmë) është zgjedhur nga zonat zgjedhore pluraliste – me shumicë, ndërsa anëtarët e tjerë janë zgjedhur nga listat e PR. Sipas MMP, mandatet e Listës PR kompensojnë secilin jo-proporcionalitet prodhuar nga rezultatet e zonës zgjedhore.

Lista e Hapur - Një formë e Listës PR në të cilën votuesit mund të shprehin preferencën për një kandidat brenda një listë të partisë, si dhe votimin për partinë.

Sistemi paralel - Një sistem gjysmë – proporcional në të cilin përfaqësimi proporcional përdoret së bashku me sistemin pluralist – të shumicës, por ku, për dallim nga MMP, mandatet e PR nuk kompensojnë jo-proporcionalitetit që dalin nga zgjedhjet e mandateve pluraliste – të shumicës.

Bllok votimi për parti (BP) - Një formë e BV, në të cilin votuesit zgjedhin midis partive e jo mes kandidatëve. Partia e suksesshme në mënyrë tipike do të fitojë secilin mandat në zonën zgjedhore.

Sistemet pluraliste – të shumicës

– karakteristika dalluese e sistemeve pluraliste – të shumicës janë se ata pothuajse gjithmonë përdorin zonat zgjedhore me mandat të vetëm. Në një sistem FPTP, fituesi është kandidat me shumicën e votave, por jo domosdo një shumicë absolute të votave. Kur ky sistem përdoret në zonë zgjedhore me shumë mandate, ai bëhet BV. Shumica e sistemeve, të tilla si sistemi australian i votës alternative (AV) dhe sistemi francez me dy raunde, përqipen të sigurojnë që kandidati fitues të fitojë shumicën absolute të votave të hedhura.

Votimi preferencial - sistemet zgjedhore në të cilat votuesit mund të përcaktojnë radhitjen e kandidatëve në fletëvotim në mënyrë si dëshirojnë ata. AV, Vota e vetme e transferueshme dhe sistemi i përdorur për të zgjedhur presidentin e Shri Lankës janë të gjithë shembujt të votimit preferencial.

Përfaqësimi proporcional (PR) - Çdo sistem i cili në mënyrë të vetëdijshme përqipet të reduktojë pabarazinë midis hises së partisë të votave të fituara në nivel kombëtarë dhe hises së sajë të mandateve parlamentare. Për shembull, nëse një parti fiton 40 përqind të votave, ajo duhet të fitojë përafërsisht 40 përqind të mandateve.

Sistemet gjysmë - proporcionale (Gjysmë - PR) - Ata sisteme zgjedhore që sigurojnë, mesatarisht, rezultatet që bien diku në mes të sistemeve PR proporcionale dhe jo-proporcionalitetit të sistemeve pluraliste – të shumicës.

Vota e vetme e pa transferueshme (SNTV) - Një sistem gjysmë –

proporcional që kombinon zonat zgjedhore me shumë mandate me metodën FPTP të numërimit të votave dhe në të cilin votuesit kanë vetëm një votë.

Vota e vetme e transferueshme (STV) - Një sistem proporcional preferencial përfaqësimit i përdorur në zonat zgjedhore me më tepër mandate. Për të fituar zgjedhjet, kandidatët duhet të tejkalojnë një kuotë të caktuar të votave me preferencë të parë.

Preferencat e votuesve rivendosen te kandidatët e tjerë kur një kandidat i pasuksesshëm përjashtohet apo nëse një kandidat i zgjedhur ka tepriçë të votave.

Sistemi i dy rundeve - Një sistem pluralist – i shumicës në të cilin mbahen zgjedhjet e dyta në qoftë se asnjë kandidat nuk arrin shumicën absolute të votave në zgjedhjet e para.

Shtojca III

Integrimi i çështjes të pakicave në Vëzhgimin e Zgjedhjeve të ODIHR-it

MBIKËQYRJA E ZGJEDHJEVE

I. Hyrje

PËRMBAJTJA

I. HYRJE

II. ROLI I ODIHR-it NË FAZËN PARAMISIONIT

Tabela 1: Shqyrtimi legjislativ

III. ROLI I MISIONIT TË VLERËSIMIT TË NEVOJAVE

Tabela 2: Çështjet e regjistrimit të votuesve

IV. ROLI I EKIPI THELBËSOR TË MISIONIT PËR VËZHGININ E ZGJEDHJEVE (MVZ)

Tabela 3: Çështjet e edukimit të votuesve

V. ROLI I VËZHGUESVE AFATGJATË

VI. ROLI I VËZHGUESVE AFATSHKURTËR

VII. RAPORTIMI PËR ÇËSHTJET E PAKICAVE NACIONALE

VIII. REKOMANDIME PËR MVZ-të NË TË ARDHMEN

SHTOJCA 1 Çështjet e Pakicave Kombëtare dhe teknikat e vëzhgimit

Në çfarë mase sistemi zgjedhor i Shteteve anëtare mund të ndihmojë përfaqësimin e pakicave kombëtare në organet e zgjedhura ngrit probleme interesante për Misionet Vëzhguese të Zgjedhjeve (MVZ) të ODIHR-it në drejtim të standardeve ndërkombëtare. Sfida për ODIHR-in është t'ju sigurojë MVZ-ve kornizë për të vlerësuar shkallën në të cilën Shtete anëtare plotësojnë këto standarde, duke marrë tërësisht parasysh përvojën krahasuese në rajonin e OSBE-së dhe dinamikën politike të vendit në fjalë.

Ky seksion do të përqipet për ti vendosur Rekomandimet e Lundit në kontekstin e punës dhe metodologjisë ekzistuese të një MVZ të ODIHR-it, duke theksuar faktorët e rëndësishëm që duhet të merren parasysh dhe duke kërkuar të identifikojnë mënyra me të cilat ata mund të jenë në mënyrë adekuate të adresuara.

Formati i dokumentit konsideron secilën komponent të MVZ, nga Seksioni i Zgjedhjeve i ODIHR-it për vendosjen e vëzhguesve afat shkurtër (VASH). Sugjerimet janë ofruar gjithashtu për atë se si rezultatet mund të raportohen, si brenda një MVZ ashtu edhe publikisht. Së fundi, janë rekomanduar disa ndryshime në metodologjinë ekzistuese të MVZ-ve të ODIHR-it me qëllim që të akomodojnë këtë qasje të re.

II. Roli i ODIHR-it në fazën para misionit

- ▶ Seksioni zgjedhor i ODIHR-it rregullisht shqyrton legjislacionin përkatës para fillimit të Misionit të Vlerësimit të Nevojave (NAM). Kjo do të përfshijë:
 - Ligjin e zgjedhjeve;
 - Kushtetutën;
 - Ligjin për partitë politike;
 - Ligjet dhe vendimet e tjera relevante që ndikojnë në proces, të tilla si themelimi i komisioneve (këshillave) zgjedhore dhe mbulimi i fushatës nga mediumet.
- ▶ Përveç kësaj, ODIHR-i duhet të merr kopjet e secilit raport mbi gjendjen e pakicave kombëtare në vend që të shqyrtojë. Kjo mund të përfshijë:
 - Ligjin mbi pakicat kombëtare;
 - Raportet e OSBE-së, raportet e KLPK, raportet e Këshillit të Evropës mbi zbatimin e Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, ose raportet e misionit të vetë shtetit;
 - Raportet e OJQ-ve ndërkombëtare dhe të vendit, etj.
- ▶ Kur ODIHR-i kryen vlerësimin e legjislacionit zgjedhor, duke definuar se a thua korniza ligjore që rregullon procesin zgjedhor është në përputhje me Zotimet e OSBE-së, vlerësimi duhet të përfshijë konsiderimin e çështjes së pakicave kombëtare në përputhje me udhëzimet e pranishme.

Tabela e mëposhtme ngre disa nga çështjet themelore që mund të parashtrohen:

Tabela 1

- ✓ thua kushtetuta ofron të drejtën e përgjithshme të votimit pa kufizime që kanë të bëjnë me pakicat kombëtare?
- ✓ ka ndonjë kriter të veçantë për të drejtat e votimit lidhur me pakicat kombëtare, dhe athua ata shkaktojnë shqetësime?
- ✓ ka dispozita të veçanta brenda ligjeve zgjedhore për pjesëmarrjen e pakicave kombëtare?
- ✓ është e drejtë për të formuar një parti politike apo grupim politik e aplikuar nga të gjithë pa kufizimeve që kanë për qëllim parandalimin e pjesëmarrjes së pakicave kombëtare?
- ✓ ka ndonjë kufizim në krijimin e partive politike bazuar në identitetin shoqërorë?
- ✓ thua ligji zgjedhor shkakton ndonjë lloj pengese administrative që kufizon pjesëmarrjen e drejtë të kandidatëve/ partive nga pakicat kombëtare?
- ✓ thua pjesëmarrja e kandidatëve nga pakicat kombëtare paragjykohet nga kërkesat e paarsyeshme?
- ✓ thua dispozita për financimin e partive/ kandidatëve (ku është e aplikueshme) është e barabartë në ligj dhe në praktikë?
- ✓ thua rregulloret e medimeve ju ofrojnë kandidatëve/ partive të pakicave kombëtare qasje të arsyeshme dhe qasje të drejtë?

III. Roli i misionit për vlerësimin e nevojave

▶ **Vlerëson Kornizën e Përgjithshme Legjislative**

Varësisht nëse analiza e kornizës legjislative ka qenë kryer para NAM, ekipi NAM duhet të kërkojë të identifikojë shqetësimet kryesore dhe implikimet politike të ligjeve përkatëse.

Bazuar në tabelën 1 më sipër, NAM duhet të vlerësojë në çfarë mase dispozitat ligjore mund të kufizojnë pjesëmarrjen e pakicave kombëtare.

Nëse një analizë e plotë është tanimë e realizuar, NAM duhet të ngre çështjet dhe brengat kryesore me bashkëbiseduesit e tyre për të fituar njohuri më të madhe për çështjet.

▶ **Takon Përfaqësuesit e Shoqërisë Politike dhe Shoqërisë Civile**

Një nga arsyt kryesore për NAM është që të takohet me përfaqësuesit e institucioneve dhe organizatave kryesore. Lidhur me çështjet e pakicave kombëtare, bashkëbiseduesit mund të përfshijnë:

- Komisionin Qendror të Zgjedhjeve/ Ministrinë përgjegjëse për zgjedhjet;
- Ministrinë qeveritare përgjegjëse për pretendimet e qytetarëve;

- Partitë politike, duke përfshirë edhe partitë që përfaqësojnë pakicat kombëtare;
- Grupet/ përfaqësuesit e interesave të pakicave kombëtare;
- OJQ-të ndërkombëtare dhe vendore që merren me çështjet e pakicave kombëtare;
- Mediumet lokale, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e pakicave kombëtare.

Gjatë këtyre takimeve, NAM duhet të ngre ndonjë shqetësim të veçantë që ka dalë në pah, të tilla si gjatë analizës së kornizës ligjore, ose në bazë të zgjedhjeve të mëparshme apo zhvillimeve të fundit.

▶ **Vlerëson Procesin e marrjes së Shtetësisë dhe Implikimet për regjistrimin e votuesve**

Gjatë takimeve për NAM, është e rëndësishme të verifikohet nëse ndonjë pakicë kombëtare ka hasur në pengesa duke u përpjekur të regjistrohet për të votuar. Kjo mund të jetë për shkak të problemeve me marrjen e shtetësisë, në të cilin rast NAM duhet të shqyrtojë çështjen e shtetësisë me organin përkatës.

Tabela 2 poshtë paraqet disa prej çështjeve të cilat mund të parashtrohen:

Tabela 2
<ul style="list-style-type: none">✓ është vendbanimi ose adresa e përhershme e kërkesës për regjistrim?✓ thua ndonjë pakicë kombëtare në veçanti përballohet me problemin e regjistrimit si votues?✓ janë këto probleme legjislative, administrative ose politike?✓ janë autoritetet duke bërë përpjekje të mirëfilltë për të korrigjuar mangësitë?✓ Cila duhet të jetë shtrirja politike e boshllëqeve në procesin e regjistrimit?✓ do të ndikojë në nivelin e përfaqësimit të pakicave kombëtare?✓ mundet një qytetar pa dokumente identifikimi të regjistrohet për të votuar?

Vlerëson deri në çfarë mase mund të ketë kufizime në mundësinë për përfaqësimin e pakicave kombëtare për shkak të dispozitave në procesin për emërimin e kandidatëve, formimin e partive, etj

Kufizimet e tilla mund të përfshijnë:

- Kufizimet mbi formimin e partive me një identitet të shoqërisë;
- Kërkesa gjuhësore për kandidatët e propozuar.

▶ Vlerëson rregulloret për mediumet

NAM duhet të konstatojë se a ka kufizime për pakicat kombëtare që të kenë qasje deri te mediumet.

Kufizimet mund të përfshijnë:

- Mungesa e mbulimit nga mediu-
met në zonat periferike të popul-
luara nga pakicat kombëtare;
- Nuk ka transmetim në gjuhën e
pakicës kombëtare;
- Mungesa e qasjes për kandi-
datët/ partitë e pakicave kom-
bëtare;
- Mbulimi i pabarabartë për
kandidatët/ partitë e pakicave
kombëtare.

IV. Roli i ekipit thelbësor i misionit për vëzhgimin e zgjedhjeve

▶ Përgatit Pasqyrën e Pakicave Kombëtare në shtet

Një nga detyrat e para të një MVZ duhet të jetë të përpilojë një pasqyrë të pakicave kombëtare në shtet. Kjo pasqyrë mund të përfshijë:

- Identifikimin e zonave në të cilat pakicat kombëtare janë të pranishme;
- Identifikimin e çështjeve kryesore të ngritura nga NAM / shqyrtimi i ligjit/ raporte të tjera;
- Identifikimin e partive kryesore/ kandidatëve/ grupeve që përfaqësojnë pakicat kombëtare;
- Përfshirja e zonave të pakicave kombëtare në planin e shpërndarjes të VAGJ;
- Informimi i shkurtër për vëzhguesit afatgjatë (VAGJ) të vendosur në këto zona (shih VAGJ më poshtë).

▶ Takon Përfaqësuesit e Shoqërisë Politike dhe Civile në vazhdimsi

MVZ duhet të vazhdojë të takohet me përfaqësues të qeverisë, partive, sho-

qërisë civile dhe grupeve të pakicave kombëtare në gjithë misionin, duke kërkuar të marrin informata kthyesë për çështjet dhe shqetësimet.

▶ Ndjekin Regjistrimin e votuesve dhe përpilimin e listave zgjedhore

Përdorimi i informatave nga takimet e VAGJ dhe takimet e vazhdueshme me përfaqësuesit lokal, ndjekin çështjet e ngritura në Tabelën 2 më sipër.

▶ Edukimi qytetar dhe edukimi i votuesve

Secili edukim i votuesve i ndërmarrë duhet të jetë gjithashtu në gjuhët e pakicave kombëtare. Informatat lidhur me zgjedhjet normalisht duhet të përfshijnë:

- Informatat për kandidatët e mundshëm;
- Informatat para zgjedhore për votuesit;
- Informatat për ditën e votimit për votuesit.

Një MVZ mund të përfshijnë pikat e mëposhtme në kornizën e saj analitike për personelin kryesor dhe VAGJ:

Tabela 3

- ✓ A thua ligji e obligon komisionin qendror zgjedhor, apo ndonjë organ tjetër, që në mënyrë adekuate të informojë zgjedhësit për të gjitha aspektet e procesit zgjedhor? A u plotësua ky detyrim?
- ✓ A thua mediet kombëtare dhe lokale kanë përmbushur përgjegjësinë e tyre përkatëse për të informuar popullatën?
- ✓ A thua ish-in kandidatët e ardhshëm të informuar mjaft mirë për të kërkuar dhe të zbatuar regjistrimin?
- ✓ A kishte numër të madh të fletëvotimeve të pavlefshme, duke treguar mungesën e të kuptuarit në mesin e votuesve?
- ✓ A ish-in fletëvotimet e pavlefshme të përqendruara në një zonë të veçantë ose në mesin e ndonjë grupi të veçantë shoqëror?
- ✓ A ish-in mjetet e komunikimit të fushatës së edukimit të votuesve dhe edukimit qytetar të përshtatshme për të arritur të gjitha pjesët e vendit?
- ✓ A thua pakicat në zonat e largëta kanë qasje deri te materialet e edukimit të votuesve dhe edukimit qytetar?
- ✓ A ish-in gjuhët e pakicave të shfrytëzuara për programet për votuesit dhe edukimin qytetar?

- ▶ Ndjek procedurat për emërimin e kandidatëve dhe partive

Përveç analizimit të shkallës në të cilën legjislati ekzistues mund të kufizojë ose parandalojë pjesëmarrjen e pakicave (të tilla si me kërkesë strikte gjuhësore), një MVZ duhet gjithashtu të ndjekë zbatimin e legjislatit aktual.

Stafi i përshtatshme bazë dhe VAGJ duhet të monitorojnë procesin e emërimit dhe hetojnë rastet e refuzimit të propozimit të emërimit. Personeli bazë dhe VAGJ duhet të takohen rregullisht me përfaqësuesit e partive të pakicave/ grupet/ kandidatët dhe, në rastet kur emërimin është refuzuar, duhet të mbledhen të gjitha kopjet e dokumentacionit përkatës. Pastaj duhet

të mbahen takimet me komisionin zgjedhor përkatës/ ministrinë për sqarimin e çështjes.

- ▶ Moniton mediet

Konsiderimi i pjesëmarrjes korrekte të pakicave kombëtare duhet të jetë pjesë e metodologjisë standarde të ODIHR-it për monitorimin e medieveve.

Brengat kryesore janë:

- A thua partitë e pakicave/ kandidatët kanë qasje të arsyeshme dhe korrekte deri te mediet?
- A thua janë mediet në dispozicion në gjuhën (t) e pakicave kombëtare?
- A thua pakicat në zonat e largëta kanë qasje të mjaftueshëm në medie?

► Vëzhgon fushatën

Si pjesë e vëzhgimit të rregullt të fushatës zgjedhore, MVZ duhet inkorporoj konsideratën e pakicave kombëtare në metodologji.

Pyetje të rëndësishme që parashtrihen në metodologjinë themelore të fushatës përfshijnë:

- A kishte liri të lëvizjes dhe grumbullimit në zonat e pakicave? A ishin votuesit të penguar nga pjesëmarrja në mbledhjet, ose a ishin partitë dhe kandidatët e parandaluar të lëvizin rreth zonave të tyre zgjedhore dhe organizimin e takimeve?
- A ju lejohet shoqatave dhe partive të pakicave kombëtare të përdorin objektet publike gjatë fushatës?
- A mund pakicat kombëtare të shtypin dhe shfaqin posterë të fushatës publikisht?
- A munden të printojnë këto posterë dhe të bëjnë fushatë në gjuhën e pakicave?
- A thua kishte ndonjë fushatë ose frikësim kundër pakicave kombëtare nga grupe ose autoritete të tjera, që ndoshta kanë dashur të nxisin urrejtje?

► Vlerëson ndikimin e sistemit dhe zonave zgjedhore mbi pakicat kombëtare

Nëpërmjet takimeve me përfaqësuesit e pakicave kombëtare dhe duke analizuar rezultatet e zgjedhjeve, MVZ duhet të jetë në gjendje të verifikojë nëse sistemi zgjedhor dhe përpilimin i zonave zgjedhore ka pasur ndikim mbi përfaqësimin e pakicave kombëtare.

Faktorë të rëndësishëm për t'u marrë parasysh janë:

- A kanë siguruar pakicat përfaqësimin? Nëse po, në çfarë mase është i krahasueshëm me proporcionin e tyre të popullsisë?
- A thua janë zonat zgjedhore të përpiluara në mënyrë që ju shërben të minimizojnë ose përjashtojnë përfaqësimin e pakicave kombëtare?
- A thua njësitë zgjedhore janë tërhequr përtej kufijve natyrore demografike, dhe me këtë pakica kombëtare është e ndarë dhe prandaj edhe e nënshtruar nga popullata shumicë në zonat zgjedhore?
- Bazuar në numrin e personave të regjistruar si votues, a thua pakicat kombëtare janë të papërfaqësuar duke pasur një numër më të madh të votuesve në zonat e tyre zgjedhore se sa në tjerat?
- A është dhënë ndonjë konsiderim për qytetarët nomadë?

V. Roli i vëzhguesve afatgjatë (VAGJ)

- ▶ Kornizë e përpiluar nga Ekipi thelbësor

Ekipi thelbësor i MVZ duhet të përfshijnë çështjet dhe pyetjet e pakicave kombëtare si pjesë e kuadrit analitik për VAGJ.

Kjo do të përfshijë:

- Ngërthimin e pyetjeve dhe çështjeve në materialet informuese të VAGJ duke përfshirë:
 - ▶ Listën e personave relevant/organizatave që duhet ti takojnë VAGJ, të tillë siç janë komisionet zgjedhore, partitë politike/kandidatët, përfaqësuesit e pakicave kombëtare, grupet e shoqërisë civile, mediumet;
 - ▶ Lista e pyetjeve të rëndësishme për të parashtruar lidhur me opinionet mbi ligjin dhe sistemin zgjedhor, emërimin e kandidatëve, regjistrimin e votuesve, fushatën zgjedhore, etj.
- Shpërndarja e VAGJ duhet të marrë në konsiderim zonat me

përqendrim të pakicave kombëtare, dhe ekipet e tilla të VAGJ duhet të informohet posaçërisht.

- ▶ VAGJ duhet plotësisht të informojnë VASH

VAGJ me përgjegjësi për zonat me përqendrim të pakicave kombëtare duhet të sigurojnë që ekipet e VASH të vendosura në ato zona të jenë të informuar plotësisht për veçoritë e zonës.

Materialet e shkruara nga VAGJ duhet t'ju shpjegojnë qartë VASH përbërjen demografike të zonës dhe të identifikojnë çështjet dhe shqetësimet kryesore.

VAGJ duhet të sigurojnë që VASH në mënyrë të duhur të mbulojnë vendvotimet (qendrat e votimit) që ju shërbejnë komuniteteve të pakicave kombëtare. Çështjet që duhet të konsiderohen janë të përshkruara më poshtë.

VI. Roli i vëzhguesve afatshkurtër (VASH)

Ku është e përshtatshme, Formularët e raportimit të VASH duhet të përfshijnë seksione të veçanta për çështjet e pakicave, dhe informimi i VASH duhet të mbulojë të njëjtat pyetje.

- ▶ Niveli i pjesëmarrjes dhe i kuptimit të procesit

Formularët e raportimit të VASH mund të bëjnë pyetje lidhur me nivelin e pjesëmarrjes dhe të kuptuarit të procesit nga ana e votuesve.

VASH në zonat me pakicë kombëtare duhet të inkurajohen të raportojnë në mënyrë specifike mbi këto çështje, pasi ato janë shumë të rëndësishme për vlerësimin e pjesëmarrjes së pakicave dhe masën në të cilën çështjet e regjistrimit të votuesve dhe edukimi i votuesve kanë qenë drejtuar nga autoritetet.

- ▶ Dëshmi mbi kërcënimet ose kufizimin e lëvizjes

Si më sipër, prej të gjithë VASH do të pyeten për raste të frikësimit të votuesve ose kufizimit të lëvizjes.

VASH duhet të pyetet se a thua ka pasur, për shembull, postblloqe ose numër të madh të policisë/ forcave të sigurisë/ aktivistëve partiak ose që pengonin votuesit të marrin pjesë ose i

frikësonin ata që të votojnë për ndonjë parti/ kandidat të veçantë.

- ▶ Saktësia e Listave të votuesve

Nga VASH duhet të kërkohet që të vëzhgojnë nga afër përpilimin e votuesve në zonat me pakica kombëtare dhe të kontrollojnë rastet e votuesve të cilët nuk janë në listat e votuesve. Në qoftë se rastësia e emrave që mungojnë është e lartë, VASH duhet të kërkojë prej komisioneve zgjedhore (përfshirë në nivel të zonave) dhe votuesit për sqarim të mundshëm?

- ▶ Sigurimi i vendotimeve (qendrave të votimit) dhe përbërja e komisioneve zgjedhore

VASH duhet të raportojnë për qasjen në vendotime për pakicat kombëtare. Për shembull, a ishin vendotimet e vendosura në vend që e bënin të pamundur të votojnë pa pengesë të panevojshme dhe pa pasur nevojë të udhëtojnë në distanca të tepërta?

VASH duhet gjithashtu të kenë një ndjenjë të përbërjes së komisioneve zgjedhore dhe se në çfarë mase ato pasqyrojnë komunitetin lokal.

VII. Raportimi për çështjet e pakicave kombëtare

▶ NAM Raporti

NAM raport duhet të përfshijë një seksion të veçantë për pakicat kombëtare në qoftë se ka shqetësime serioze që duhet theksuar. Kjo është e rëndësishme, pasi që ajo ngre çështje që mundën pastaj të inkorporohen në kuadër të kornizës analitike të MVZ, duke përfshirë vendosjen e vëzhguesve në zonat në fjalë.

▶ Raportet e Misionit të Brendshëm: Raporti Javor/Raportet e VAGJ/Raportet e VASH

Siç u përshkrua më lartë, VAGJ do të raportojnë mbi çështjet me interes për pakicat kombëtare. Çështjet e rëndësishme mundën gjithashtu të ngrihen në raportet javore të MVZ të Seksionit zgjedhor të ODIHR-it.

VASH mund të raportojnë edhe nëpërmjet të formave të raporteve të rregullta edhe gjatë debriefing-ut të VASH, cili do të përqendrohet në rajonin e informatës specifike.

▶ Deklaratë për shtyp dhe Rezultatet paraprake dhe konkluzionet

Nëse ka ndonjë shqetësim të rëndësishëm gjatë MVZ, këto mund të jenë të përfshira në deklaratën për shtyp pas zgjedhjeve dhe rezultateve dhe përfundimeve paraprake.

▶ Raporti përfundimtar/ Shtojcat

Çështjet dhe shqetësimet në lidhje me pakicat kombëtare duhet të jenë ngritur në Raportin përfundimtar të ODIHR-it mbi zgjedhjet e dhënë në fjalë. Nëse ka çështje të rëndësishme kombëtare në lidhje me minoritetet, atëherë duhet të konsiderohet një shtojcë më e gjatë në raportin përfundimtar. Kjo do të lejojë më tepër fushëveprim për diskutim të çështjeve.

▶ Raporti Special për Minoritetet (pakicat) kombëtare

Shiko më poshtë.

VIII. Rekomandime për mvz-të e ardhshme

- ▶ Kontakt personi për Pakicat Kombëtare

Një ekspert në MVZ, ndoshta Analisti politik, duhet të jetë Kontakt Personi për pakicat kombëtare.

Kontakt Personi mund të punojë me Shefin e Misionit për të përcaktuar kornizën analitike për VAGJ dhe për të përpiluar raportet me shkrim. Kontakt Personi do të jetë gjithashtu përgjegjës për grumbullimin e të gjitha raporteve

të VAGJ mbi çështjet e pakicave kombëtare.

Një specialist vendas për pakicat kombëtare duhet të përfshihet në punën e MVZ-së nën mbikëqyrjen e Analistit politik ose Kontakt Personit.

VASH dhe VAGJ në zonat ku ka përqendrim të madh të pakicave kombëtare duhet t'ju sigurohet përkthyes me gojë në dy gjuhët edhe të pakicës edhe të shumicës.

SHTOJCA 1

Çështjet e Pakicave Kombëtare dhe teknikat e vëzhgimit

Rekomandimi	Çështja	Teknikat e vëzhgimit	Përgjegjësia
E drejta e personave që ju takojnë pakicave kombëtare për të marrë pjesë në zbatimin e punëve publike, përfshirë këtu edhe nëpërmjet të drejtës për të votuar dhe për tu kandiduar për zyrë pa diskriminim	Korniza legjislative	Vlerësimi i kushtetutës, ligjit zgjedhor dhe të legjislacionit tjetër përkatës për të vlerësuar nëse ato në mënyrë të përshtatshme mundësojnë të drejtat themelore të njeriut për pakicat kombëtare	Vlerësimi paraprak për pakicat kombëtare (NAM)/ NAM/ MVZ
		Takimi me përfaqësuesit e pakicave kombëtare, partive politike dhe përfaqësuesit e qeverisë për identifikimin e çështjeve kryesore për pakicat kombëtare në shtet	NAM/ MVZ / VAGJ
	Regjistrimi i votuesve dhe shtetësisë	Kontrolloni me grupet e pakicave kombëtare dhe zyrtarët relevant nëse ka probleme për pakicat kombëtare në lidhje me sigurimin e shtetësisë dhe/ ose regjistrimin e votuesve	NAM/ MVZ/ VAGJ
		Kontrollo shifrat e regjistrimit të votuesve për zonat zgjedhore relevante dhe vëzhgo procesin administrativ për ndryshimin/ azhurnimin e listave zgjedhore	VAGJ

Rekomandim	Çështja	Teknika e vëzhgimit	Përgjegjësia
Duhet të ekzistojë liri për të vendosur themelimin e partive politike të bazuara mbi identitetet shoqërore si dhe ato që identifikohen vetëm me interesin e një komuniteti të veçantë	Edukimi zgjedhor dhe qytetar	Kontrolloni nëse edukimi i votuesve dhe qytetarëve janë të targetuar për të përmbushur nevojat e pakicave kombëtare, si në gjuhën e përdorur ashtu edhe në mënyrën e komunikimit	MVZ/VAGJ
	Emërimi i kandidatëve dhe partive politike	Kontrolloni nëse ka ndonjë dispozitë që lidhet me emërimin e partive dhe kandidatëve, të tilla si dispozita e gjuhës, që mund të shërbejë për të parandaluar pjesëmarrjen e përfaqësuesve të pakicave kombëtare	NAM /MVZ
	Të drejtat e fushatës dhe qasja te mediumet	Kontrolloni nëse kandidatët/ partitë nga pakicat kombëtare janë të lirë të zbatojnë fushatën në gjuhën e zgjedhur të tyre, në mitingje, në materialet e shtypura dhe përmes transmetimeve në mediumet	NAM /MVZ
	Themelimi i partive politike	Kontrolloni në qoftë se kandidatët e pakicave/ partitë janë të lira të organizojnë dhe mbajnë tubime dhe takime politike pa kërcënime ose ndërhyrje të pa-nevojshme A ka ndonjë pengesë legislative ose administrative për formimin e partive politike të bazuara mbi identitetin shoqërorë?	MVZ/VAGJ

Rekomandim	Çështja	Teknika e vëzhgimit	Përgjegjësia
	Financimi i partive politike	<p>MVZ duhet të ndjekin procesin e emërimit për të kontrolluar nëse fryma dhe teksti i legjisllacionit janë ndjekur në praktikë</p> <p>Vlerësoni se a thua mekanizmi për sigurimin e mbështetjes financiare të partive/kandidatëve është korrekt dhe nëse është zbatuar siç duhet</p>	MVZ/VAGJ
Sistemi zgjedhor duhet të lehtësojë përfaqësimin dhe ndikimin e pakicave kombëtare	Zgjedhja e sistemit zgjedhor	<p>Duhet të bëhet një analizë e plotë e sistemit zgjedhor dhe implikimeve të tyre mbi secilën pakicë kombëtare</p> <p>Një analizë përfundimtare mbi korrektesinë e sistemit lidhur me pakicat kombëtare që duhet të konsideratë të plotë për kulturën politike kombëtare, historinë politike të kohëve të fundit, implikimet e sistemeve të tjera mbi zhvillimin politik dhe demokratik të shtetit, dhe kontekstin rajonal</p>	MVZ
Kufijtë gjeografik të zonave zgjedhore duhet të lehtësojnë përfaqësimin e pakicave kombëtare	Përcaktimi i kufijve të zonave zgjedhore	<p>Të vlerësojë se a thua përcaktimi i kufijve të zonave është dizajnuar për qëllim që të përjashtojë ose përfaqësojë nën nivelin e duhur pakicën kombëtare</p> <p>Një vlerësim i tillë duhet të konsiderojë zgjidhjen e modeleve të pakicave në fjalë dhe masën në të cilat ata mund të kenë qenë akomoduar.</p>	MVZ/VAGJ

Rekomandim	Çështja	Teknika e vëzhgimit	Përgjegjësia
	Madhësia e zonës zgjedhore	Në bazë të shifrave të regjistrimit për secilën zonë zgjedhore, duhet të bëhet një vlerësim në numrin e votuesve për secilën zonë zgjedhore për të verifikuar se a thua madhësia e zonës zgjedhore është në përputhje me trendin e përgjithshëm kombëtar dhe në përputhje me legjislacionin zgjedhor.	MVZ/VAGJ